



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Shkenca Mjedisore”  
profili “Menaxhim i Burimeve Natyrore”  
Universiteti Bujqësor i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**


**Prof. Mihallaq QIRJO**

**Dr. Genti KROMIDHA**

**Shtator / 2023**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në “Shkenca Mjedisore” profili ‘Menaxhim i Burimeve Natyrore’**

1	IAL aplikues:	Universiteti Bujqësor i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Mjedisit dhe i Burimeve Natyrore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Shkenca Mjedisore” profili ‘Menaxhim i Burimeve Natyrore’
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr 405, datë 12.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	30 PAE / 0 PAK
18	Numri i studentëve:	2020 – 2021 54 studentë 2021 – 2022 24 studentë 2022 – 2023 8 studentë
19	Komente / të tjera:	-



## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

E gjithë puna e Grupit të vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në Shkenca Mjedisore me profil “Menaxhim i Burimeve Natyrore” është përqëndruar në Dosjen e Vetvlerësimit të dorëzuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi, në vizitën në Institucion dhe në takimet që kemi realizuar si Grup Vlerësimi.

Në këtë Raport janë pasqyruar të dhënat që kanë dalë si rezultat i punës dhe i analizës së GVJ mbi procesin e vlerësimit të jashtëm.

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Mjedisore me profil “Menaxhim i Burimeve Natyrore” objekt i vlerësimit, është hapur me Urdhërin e MASR Nr 405, datë 12.07.2018 ‘Për hapjen e programit të ciklit të parë të studimit ‘Bachelor’ në “Shkenca Mjedisore”, profile “Menaxhim i Burimeve Natyrore” në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Programi i studimit ofrohet pranë Departamentit të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Programi i studimit i përket ciklit të parë të studimeve Bachelor, nivelit 6 (gjashtë) në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, ofrohet në gjuhën shqipe, me një total prej 180 ECTS dhe zgjat 3 vite akademike.

GVJ vëren se emërtimi i programit të studimit në pothuajse të gjitha evidencat e paraqitura në mbështetje të këtij programi në DVV, është Bachelor në Menaxhim i Burimeve Natyrore dhe jo Bachelor në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i burimeve natyrore. *Shqetësuese është fakti që edhe Modeli i Diplomës i paraqitur në DVV (Evidenca 15.3) dhe Suplementi i Diplomës (Evidenca 15.2) emërtimin e programit e kanë në kundërshtim me emërtimin e programit në Urdhërin e hapjes së MASR, gjë e cila do bëjë problem për studentët pasi të diplomohen.*


Numri i studentëve të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë (pranime) në programin e studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore, (sipas Evidencës Nr 27.1 në të cilën emërtimi i programit është Menaxhim i Burimeve Natyrore) është:

Viti akademik 2019 – 2020	88 studentë
Viti akademik 2020 – 2021	54 studentë
Viti akademik 2021 – 2022	24 studentë
Viti akademik 2022-2023	9 studentë*

Studentë të diplomuar në vitin akademik 2020-2021 janë 35 gjithsej.

\*e dhënë e marrë në raportin e e analizës së punës mësimore dhe këkimore shkencore për vitin akademik 2021-2022, pika 1.1, Evidencë 38.8.

Ndërsa në Sekretarinë mësimore, numri i studentëve për këtë vit akademik rezulonte 8 studentë.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësuesve të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga Prof. As. Mihallaq Qirjo dhe Dr. Genti Kromidha. Koordinatorë Teknikë e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Majlinda Demirneli.

GVJ mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) dhe vendosi realizimin e vizitës në Institucion më datë 20 dhe 21 Mars 2023, për të cilën u hartua edhe Agjenda e vizitës me takimet respektive.


Në bazë të Agjendës, GVJ realizoi në Universitetin Bujqsor të Tiranë takime me: Dekanin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, me Përgjegjësën e Departamentit të Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në programin e studimit, studentët e programit të studimit, përfaqësues nga Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë, përfaqësues nga Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, përfaqësues nga Sektori i Burimeve Njerëzore,, përfaqësues nga Drejtoria e Projekteve.

Gjithashtu GVJ realizoi një vëzhgim të mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) dhe një vizitë në Bibliotekën e Institucionit dhe Laboratorin Shkencor të Mjedisit.

Gjatë vizitës u kërkua Rregullorja e rekrutimit të stafit, e cila u dërgua nga institucioni dhe iu vunë në dispozicion GVJ-së.

Mbi bazën e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV), informacionit të marrë gjatë takimeve të realizuara në Institucion, si dhe dokumentave shtesë të kërkua gjatë vizitës në Institucion, GVJ ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ).

Universiteti Bujqsor i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24.07.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 38/72 Prot, datë 24.07.2023. Universiteti Bujqsor i Tiranës nuk ka dërguar komente, sugjerime në lidhje mbi Draft Raportin, sipas *Manualit 2017*, si dhe përcaktimit në agjendën e detajuar të vlerësimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “shkenca Mjedisore me profil “Menxhim i Burimeve Natyrore**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Mjedisore me profil Menaxhim i Burimeve Natyrore, është licensuar me UMASR Nr 405, datë 12.07.2018. Programi i studimit ofrohet në Departamentin e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore, pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT).</p> <p>Referuar Statutit të UBT, të miratuar nga UMASR me Urdhër Nr. 279, datë 28.07.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit Bujqësor të Tiranës” Univeriteti Bujqësor i Tiranës është vazhdues i Institutit të Lartë Shtetëror të Bujqësisë, i themeluar në vitin 1951 dhe i emëruar në vitin 1991 si “Universiteti Bujqësor i Tiranës”. UBT është një institucion i cili me programet e studimit që ka ofruar jo vetëm që nuk ka rënë ndesh me interesat kombëtare por ndër vite ka ruajtur dhe ka konsoliduar dhe vazhdon të konsolidojë vlerat akademike të vendit duke arsimuar dhe nxjerrë breza të tërë studentësh në fushën e bujqësisë, veterinarisë, zooteknisë, pyjeve, ekonomisë bujqësore, etj</p> <p><b>Evidencë 2.1 Statuti i UBT</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Referuar Statutit të UBT dhe Rregullores së programit të studimit Bsc në “Shkenca Mjedisore me profil “Menaxhim i Burimeve Natyrore”, ky program synon të krijojë një kuadër koherent dhe operacional mbi studimet universitare në drejtimin e menaxhimit të burimeve natyrore duke përcaktuar rregulla të qarta të përgatitjes, organizimit, administrimit dhe kontrollit të studimeve universitare.</p> <p>Misioni i UBT është krijimi, transmetimi, zhvillimi dhe mbrojtja e dijeve nëpërmjet mesimdhësisë, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si dhe formimi i specialistëve të lartë në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe zhvillimit rural, mjedisit dhe shkencave mjedisore, pylltarisë, veterinarisë, etj. Gjithashtu ky institucion ka si mision edhe të ndihmojë në zhvillimin e</p>

	<p>qëndrueshëm bujqësor dhe inovacionin e ekonomisë së gjelbër në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe të kontribuojë në rritje e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë.</p> <p><b>Evidencë 2.1 Statuti i UBT</b></p> <p><b>Evidencë 7.1 Rregullorja e programit të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Sipas Statutit të UBT, ky Institucion në vizionin e tij afatgjatë synon të bëhet qendra ekselente më e madhe e edukimit univeritar, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, në drejtim të zhvillimit të bujqësisë moderne dhe garantimit të ushqimit të shëndetshëm dhe cilësor. Veprimtaria akademike e UBT zhvillohet në përputhje me standardet e hapësirës europiane të arsimit të lartë dhe duke reflektuar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës. Qëllimi kryesor i këtij Institucioni është përparimi i shkencës në fushën e bujqësisë, teknologjisë bujqësore dhe arsimit të lartë nëpërmjet koordinimit të tyre dhe një vizioni afatgjatë. Ky institucion promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të bujqësisë, përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit si dhe përmes shërbimeve të ekstensionit bujqësor.</p> <p><b>Evidencë 2.1 Statuti i UBT, neni 3</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Ashtu siç është paraqitur edhe në RVB, Universiteti Bujqësor i Tiranës, është një institucion i cili është ngritur dhe funksionon prej dekadash të tëra duke përgatitur studentë të kualifikuar në fushën e bujqësisë, ekonomisë bujqësore, veterinarisë, zooteknisë, pyjeve dhe së fundmi edhe specialistë të kualifikuar në fushën e mjedisit. Programi i studimit ofrohet në Departamentin e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore (DMBN), i cili edhe pse është themeluar me këtë emërtim në vitin 2001, është vazhdim i Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë. Ky departament, DMBN, është pjesë përbërëse e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, fakultet i cili ndër vite ka demonstruar se ka qënë i suksesshëm në përgatitjen e kuadrove të lartë në fushën e Bujqësisë dhe së fundmi, në një rreth kohor prej 20 vitesh edhe në fushën e mjedisit. Sipas përgjegjësit të DMBN, ky Departament përfaqëson sot një qëndër të rëndësishme të edukimit në fushën e mbrojtjes dhe të menaxhimit të burimeve mjedisore. GVJ duke parë edhe dokumentacionin në DVV, personelin akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit të Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore, nisur edhe nga përbërja e tij, 23 PAE (12 Prof Dr; 3 Prof. As. Dr; 4 Dr dhe 4 Msc); 5 PAK (3 Dr dhe 2 Msc) si dhe nga një përbërje prej 9 personash si staf ndihmës akademik, shprehet se stafi akademik këtij</p>



	<p>Departamenti ka kapacitetet e duhura akademike për ofrimin e një programi të tillë në fushën e mejdisit. Për sa më sipër, GVJ shprehet se Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti Bujqësor ka përvojën e duhur për ofrimin e një programi të tillë.</p> <p><b>Evidencë 24.1 Personeli akademik dhe ndihmës akademik i DMBN</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Referuar Rregullores së Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, Miratuar me Vendim Dekanati Nr 10, datë 29.04.2022, në nenin 3 shkruhet shprehimisht: Rregullorja e brendshme e FBM-së ka si qëllim: të krijojë një kuadër rregullator mbi mënyrën e zhvillimit të studimeve universitare; të vendosë standard në lidhje me përgatitjen, organizimin dhe administrimin e studimeve universitare; të krijojë mekanizmat e nevojshëm për një menaxhim fleksibël në nivel fakulteti, departamenti, stafi akademik dhe personeli ndihmës.</p> <p>Referuar rregullores së programit të studimit synohet të krijohet një kuadër koherent dhe operacional mbi studimet universitare në drejtimin e menaxhimit të burimeve natyrore si dhe të përcaktohen rregullat të qarta të përgatitjes, organizimit, administrimit dhe kontrollit të studimeve universitare në drejtimin e “menaxhimit të burimeve natyrore. Ndërsa sipas Nenit 2 të saj, Qëllimi i rregullores është përcaktimi i rregullave standard për programin e studimeve universitare menaxhim i burimeve natyrore i cili është hartuar në përputhje me planin mësimor të këtij program, por duke respektuar edhe lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik, të studnetëve si dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>Pra sa më sipër fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën specifike të Fakultetit në të cilën ofrohet ky program. Në RVB është shkruar shprehimisht se: <i>hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare Europiane.</i></p> <p><i>GVJ vëren se në RVB <u>mungojnë</u> të dhënat për klasifikimin /kodifikim e programit sipas direktivave dhe udhëzimeve përkatëse.</i></p> <p><b>Evidencë Nr 6.1 Rregullore e FBM_2022</b></p> <p><b>Evidencë Nr 7.1 Rregullore e programit të studimit Bsc në Menaxhim i Burimeve natyrore</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se emërtimi i programit të studimit Bachelor në Shkenca Mjedisore me profil Menaxhim i Burimeve natyrore,</i></p>

	<p><i>paraqitet i ndryshëm në evidenca të ndryshme në Dosjen e Vetvlerësimit. Duke filluar që nga kapaku i Raportit të Vlerësimit të brendshëm, tek Rregullorja e programit të studimit, tek Diploma që ofrohet në përfundim të studimeve, emërtimi i programit paraqitet Bachelor në Menaxhim i Burimeve Natyrore. <u>Institucioni duhet të tregohet më i kujdesshëm në përcaktimin e saktë të emërtimit të programit ashtu siç është emërtimi në dokumentin e hapjes/licensimit të tij nga Ministria përkatëse, pasi një emërtim i gabuar penalizon drejtpërdrejtë studentët që ndjekin këtë program.</u></i></p> <p><i>Programi është në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</i></p> <p><i><u>Në RVB nuk janë paraqitur të dhëna për kodifikimin e programit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare.</u></i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Statuti, Analizat vjetore të Departamentit të Menaxhimit të Burimeve natyrore, Rregulloret e paraqitura nga Grupi i vlerësimit të brendshëm në dosjen e vetvlerësimit, demonstrojnë angazhimin e institucionit në lidhje me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bsc në Shkenca Mjedisore me profil “Menaxhim i Burimeve Natyrore” sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Sipas Rregullores së Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, neni 5, Departamentet, pjesë përbërëse të këtij fakulteti janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore;</li> <li>- Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve;</li> <li>- Departamenti i Shkencave Agronomike;</li> <li>- Departamenti i hortikulturës dhe Arlitekturës së Peizazhit;</li> <li>- Departamenti i Shkencave Zooteknike;</li> </ul>



	<p>- Departamenti i Akuakulturës dhe peshkimit;</p> <p>Të gjitha këto Departamente janë njësi bazë të zhvillimit, mësimdhënies dhe të punës kërkimore – shkencore të Fakultetit, të cilat përfshijnë fusha kërkimi të përafërta dhe grupojnë disiplina mësimore respektive.</p> <p>Referuar Analizës së punës së Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit të vitit 2021-2022, vërehet një tregues i mirë i punës së këtij fakulteti në lidhje me programet që ofron, mundësitë e përmirësimit, marrdhëniet e bashkëpunimit, duke bërë një analizë të mirëfilltë të të gjithë vijueshmërisë së tij.</p> <p><b>Evidencë Nr 6.1 Rregullore e FBM_2022</b></p> <p><b>Evidencë Nr 38.1 Analiza FBM 21-22</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar RVB, për realizimin e objektivave të programit, Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh për tu ardhur në ndihmë studentëve që studiojnë në këtë program.</p> <p>GVJ mbështetur në evidencat në DVV, konkretisht <i>Evidenca 34.2_Lista e sipërmarrjeve brenda vendit në marrëveshje me UBT</i>, vëren se nga Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore janë listuar një sërë sipërmarrjesh, organizatash dhe Institucione me të cilat Universiteti Bujqsor i Tiranës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Për këto marrëveshje nuk jepet një e dhënë se konkretisht për çfarë do të shërbejë ky bashkëpunim dhe afatet kohore në të cilat do të shtrihet bashkëpunimi midis UBT dhe Institucionit përkatës.</p> <p><b>Evidenca 34.2:Lista e sipërmarrjeve brenda vendit në marrëveshjet me UBT</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit, Institucioni deklaron në raportin e vetvlerësimit se ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme për realizimin e praktikës profesionale të këtij programi.</p> <p>Referuar Rregullores së programit të studimit, <i>neni 11</i>, Organizimi i Praktikave profesionale, GVJ konstaton se në këtë nen janë të përcaktuara qartë se ku dhe si është parashikuar realizimi i praktikës profesionale për këtë program studimi. Po sipas këtij neni, Praktika profesionale do të zhvillohet në qendra apo Institucione të miratuara nga autoritete drejtuese përkatëse dhe të kenë detyrime të kontraktuara me UBT-në.</p> <p>GVJ, bazuar në DVV konstaton se në këtë dosje, është paraqitur Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Agjencionit të përkrahjes së Punësimit Kosovë dhe në dosjen e Fakultetit të</p>

	<p>Bujqësisë dhe Mjedisit, me qëllim realizimin e punës praktike për studentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit. Kjo marrëveshje është lidhur më datë 29.06.2020 me një afat 3 vjeçar me të drejtë ripërtëritje edhe për tre vjet të tjera.</p> <p>Gjithashtu një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi midis Institucionit dhe institucioneve të tjera bashkëpunuese për realizimin e programit të studimit dhe për praktikën profesionale, janë sjellë të listuara në Evidencën Nr 32.1.</p> <p>Sipas kësaj evidence, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë kanë lidhur në total 49 marrëveshje të tilla, por nuk e kanë të përcaktuar kohën dhe afatin e zgjatjes s marrëveshjes. Duke qënë se Departamenti titullohet “Agromjedis dhe Ekologji”, emërtim i cili ka qënë para riorganizimit të Departamentit aktual, me emërtimin Departamenti i Mjedisit dhe i Burimeve Natyrore, marrëveshjet kanë kohë që implementohen dhe ju kanë shërbyer studentëve në realizimin e praktikave mësimore.</p> <p><b>Evidenca Nr 7.1 Rregullore e programit të studimit Bsc në Menaxhim i Burimeve natyrore</b></p> <p><b>Evidenca Nr 32.1: Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese</b></p> <p><b>Evidenca 32.2: Marrëveshje bashkëpunimi midis UBT dhe agjensionit të punësimit kosove_2020</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në dosjen e Vetvlerësimit janë paraqitur dy evidenca të analizës së punës së Fakultetit të Bujqësisë dhe mjedisit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Analiza FBM për vitin 2021-2022 (evidencë 38.1)</li> <li>2. Analiza mësimore vjetore_FBM për vitin 2020-2021 (evidencë 38.2)</li> </ol> <p>Në analizën mësimore vjetore, pika 2.12 nuk ka asnjë të dhënë për Departamentin e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore. Në këtë pikë flitet për realizimin e praktikave për disa departamente të tjera, pjesë të fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit. Gjithashtu në DVV është paraqitur nga GVB edhe evidenca 38.8 Raport mbi Analiza e punës mësimore dhe Kërkimore shkencore për vitin akademik 2021-2022, e hartuar në Nëntor 2022. Në këtë raport sërish nuk ka të dhëna për realizimin e praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi, por tek përmbledhja e problematikës së procesit mësimor, pika 2.5 shkruhet shprehimisht: <i>të orjentohej praktikat profesionale me anë të marrveshjeve në organizata të ndryshme publike dhe private</i></p>

	Evidencë 38.1 Analiza FBM për vitin 2021-2022			
	Evidencë 38.2 Analiza mësimore vjetore_FBM për vitin 2020-2021			
	Evidencë 38.8 DMBN Analiza e mësim-kërkim -2022			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ shprehet se Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, konkretisht Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve natyrore duhet të punojë më shumë për realizimin e praktikave profesionale në organizatat apo subjektet shtetërore dhe private me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për këto praktika për studentët e këtij programi studimi. Marrëveshjet duhet të jenë të qarta, me objektiva të pëcaktuara dhe me afate kohore që të mundësojnë realizimin e praktikave për të gjitha brezat e studentëve.</i></p> <p><i>Mungon një analizë e mirëfilltë e këtij departamenti për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në	Bazuar në Raportin e Vetëvlerësimit dhe vlerësimit gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në MBN realizohet në përputhje me përcaktimet e dosjes së tij dhe Rregullores së Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit. Ky program është i organizuar në lëndë/module, pesha e të cilave vlerësohet me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të

<p>përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Krediteve (ECTS). Njësia bazë ka dokumentuar të gjitha rregulloret në nivel institucioni dhe Programi studimi që organizojnë procesin mësimor dhe strukturën e programit.</p> <p>Sipas shqyrtimit të dokumentacionit të dhënë, programi i studimit është i shtrirë në tre vite akademike, në gjashtë semestra. Çdo vit akademik ka një ngarkesë prej 180 kreditesh me 60 kredite në cdo vit mësimor). Viti akademik ndahet në dy semestra, 15 javë për semestrin e parë dhe të dytin. Në planin mësimor të programit Bsc MBN parashikohen të gjitha lëndët të cilat zhvillohen gjatë secilit semester me kreditet dhe orët e ngarkesave përkatëse.</p> <p>Sipas Evidencës 14.2, për Programin Mësimor 2021-2022, shpërndarja e ECTS është për cdo Semester me 30 kredite.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve univesitare në UBT 2021</b></p> <p><b>Evidenca 6.1: Rregullore e FBM 2022</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p> <p><b>Evidenca 14.3. Plani mësimor Bch MBN i ndarë sipas veprimtarive formuese.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesioneve e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion konstatohet se programi i studimit Bch MBN synon të pajisë studentët me shprehi të një profesioni të caktuar në menaxhimin e burimeve natyrore. Objektivi i këtij programi është të krijojë specialistë që mund të orientohen në fusha të ndryshme mjedisore si administrim mjedisi, vlerësim dhe monitorim mjedisor, për tu punësuar më pas si specialistë mjedisi dhe inspektorë mjedisi në institucione shtetërore, biznese dhe agjenci të ndryshme. Programi dhe lëndët specifike janë në zbatim të Rregullores së Studimeve të FBM, dhe pajisin të diplomuarit me njohuri të profesionale në disiplina të ndryshme të menaxhimit të mjedisit dhe problematikave të tij. Hartimi i programit është bazuar në studimin e tregut të punës lidhur me menaxhimin e qendrueshëm të mjedisit dhe burimeve të tij.</p> <p>Vizita në Institucion dhe takimi me drejtuesin e njësisë bazë dhe stafin Akademik konfirmon synimin për të adresuar problematikat mjedisor të vendit përmes formimit të specialistëve të kësaj fushe.</p> <p><b>Evidenca 6.1: Rregullore e FBM 2022</b></p>

<p>specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ vëren se Programi i Studimi ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese dhe të grupuar së bashku me kreditet përkatëse. Bazuar në Evidencën 14.3, ndarja e lëndëve është me bazë kreditesh ku peshën kryesore e zënë lëndët e disiplinave karakterizuese dhe më pas ato të integruara.</p> <p>Planet mësimore janë hartuar duke u bazuar në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar. Ndarja e lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi referuar veprimtarive formuese është nga A në E. Ndarja e krediteve ndërmjet lëndëve (Tipit të Veprimtarisë) varion nga 4 ECTS deri në 7 ECTS, pavarësisht kategorisë së lëndës.</p> <p><i>Referuar Planit Mësimor 2021-2022</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndët bazë (A) – 56 kredite ose 31% (nga 15-20% që duhet të parashikohen);</li> <li>- Lëndët Karakterizuese (B) – 66 kredite ose 36.6% të krediteve (nga 50-55% që duhet të parashikohen);</li> <li>- Lëndët Ndërdisciplinore (C) – 36 kredite ose 20% të krediteve (nga 12-15% që duhet të parashikohen);</li> <li>- Lëndët Plotësuese (D) – 12 kredite ose 7 % të krediteve (nga 10-15% që duhet të parashikohen);</li> <li>- Detyrime Përmbyllëse (E) – 10 kredite ose 5.6% të krediteve (nga 3-5% që duhet të parashikohen).</li> </ul> <p><i>Referuar të dhënave sa më lart, <u>GVJ rekomandon</u> që Institucioni duhet të rishikojë programin për të përmbushur shpërndarjen e lëndëve sipas kërkesave të VKM-së nr.41/2018 për të balancuar ndarjen sidomos në kategorinë e lëndëve karakterizuese.</i></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p> <p><b>Evidenca 14.3. Plani mësimor Bch MBN i ndarë sipas veprimtarive formuese.</b></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe bisedat gjatë vizitës në institucion, programi i studimit Bch MBN ka të parashikuar praktika profesionale ne Kursin e III.</p> <p>Bazuar në Evidencën 53.1 titullari i njësisë bazë ka miratuar grupin e pedagogëve për ndjekjen e punimeve të dorëzuara nga studentët bazuar në realizimin e praktikës profesionale.</p> <p>Neni 11 ne Rregulloren e Programit te Studimit parashikon organizimin dhe përgjegjësitë e kryerjes së praktikës profesionale. Sipas Evidencës 53.3, jepen udhëzime për studentët për kryerjen e praktikës profesionale dhe mënyrën e raportimit të saj.</p> <p><i>GVJ vëren se në planin mësimor Praktika profesionale nuk është e shprehur në orë mësimore dhe kreditet përkatëse. Ndaj GVJ sugjeron përfshirjen e saj në Planin mësimor.</i></p> <p>Detyrimet përmbyllëse në këtë program janë me mbrojtjen e një temë të zhviulluar nga studenti gjatë kryerjes së praktikës profesionale, kryesisht në institucione dhe agjenci të ndryshme. Mbrojtja bëhet përpara një komisioni të miratuar nga titullari i njësisë bazë (Evidenca 53.1)</p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p> <p><b>Evidenca 53.1. Praktika profesionale 2021-2022.</b></p> <p><b>Evidenca 53.3: DAME-Udhëzim për praktikën profesionale</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ vëren se Rregullorja e Programit të Studimit (Evidence 7.1) paraqet në mënyrë të plotë gjithë formën e organizimit të këtij programi së bashku me kriteret e pranimit dhe të transferimit të studentëve. Kriteret e pranimit janë të qarta dhe të specifikuar. Dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kuadrin ligjor ne fuqi (Ligji 80/2015), ku përfshihen Rregullorja e Programit të Studimit, Plani mësimor, Syllabuset e lëndëve.</p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p> <p><b>Evidenca 14.4: Kriteret e pranimit në programin Bch MBN 2022-2023</b></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Plani Mësimor për këtë program studimi përfshin elementë të ngjashmërisë lidhur me kohëzgjatjen (3 vjeçare), kreditet dhe shpërndarjen e tyre (180 ECTS), lëndët dhe ndarjen e ngarkesës në auditor e jashtë saj për leksione, seminare, laboratore dhe praktika në terren. Ky program studimi është unik ndaj edhe është i pamundur krahasimi me programe të ngjashme në Universitete të tjera të vendit.</p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit i takon nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Veprimtaria formuese e programit të studimit BCh MBN ka veprimtari të formimit bazë, veprimtari karakterizuese, disiplina integruese, veprimtari plotësuese dhe detyrime përmblylles.</p> <p>Kodifikimi i lëndëve paraqitet në secilin program lëndë.</p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p> <p><b>Evidenca 19.2. Programet e lëndëve</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet vetëm nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se programi është i organizuar sipar kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Ai përmbush kriteret e vlerësimit lidhur me objektivat dhe qëllimin, organizimin dhe strukturën e Planit mësimor dhe të kurrikulave lëndore.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron një shpërndarje më të drejtë të lëndëve sipas tipologjisë, duke ju referuar përqindjes që zënë lëndë të ndryshme në grupin e lëndëve të formimit bazë apo karakterizues (referuar % së krediteve për çdo grup kundrejt numrit total të krediteve).</i></p>

	<i>Gjithashtu sugjerohet përfshirja e praktikës profesionale në programin mësimor me orë dhe kredite specifike, si dhe e tabelës së kodifikimi të lëndëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																					
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi i studimit Bch MBN ofrohet nga Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore, njësi bazë mësimore-kërkimore përbërëse e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, në UBT. FBM dhe DMBN ushtrojnë aktivitetin e tyre akademik dhe shkencor bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin dhe rregulloren e UBT.</p> <p>DMBN është i organizuar sipas statutit dhe rregullore së UBT. Ai drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Sipas RVB dhe Evidencës Tabela Përmbledhëse Tabela 4.3 në këtë Program Studimi janë të angazhuar 30 punonjës akademik. Sipas Tabelës 2 (Evidenca: Tabela përmbledhëse) shpërndarja paraqitet si vijon:</p> <p>GVJ konstaton se DMBN, në vitin aktual 2022-2023, ka 28 personel akademik gjithsej, 23 personel akademik efektiv (PAE) dhe 12 personel akademik me kontratë (PAK). Kualifikimi i departamentit është si si më poshtë: <b>(Evidenca: Tabela përmbledhëse tab nr. 2)</b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>12</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr. / PhD.</td> <td>4</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>4</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td><b>Në total</b></td> <td><b>23</b></td> <td><b>5</b></td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td colspan="2"><b>28</b></td> </tr> </tbody> </table>	Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore	PAE	PAK	Prof. Dr.	12	-	Prof. As. Dr.	3	-	Dr. / PhD.	4	3	MSc.	4	2	<b>Në total</b>	<b>23</b>	<b>5</b>	<b>Totali</b>	<b>28</b>	
Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	12	-																				
Prof. As. Dr.	3	-																				
Dr. / PhD.	4	3																				
MSc.	4	2																				
<b>Në total</b>	<b>23</b>	<b>5</b>																				
<b>Totali</b>	<b>28</b>																					




	<p>Për sa më lart, IAL përmbush kërkesat ligjore lidhur me organizimin dhe funksionimin e njësisë bazë, për personel akademik efektiv, dhe kriterin e gradave/titujve.</p> <p>DMBN drejton dy programe Bch: Bachelor Inxhinieri Agromjedisi; Bachelor Menaxhim i Burimeve Natyrore dhe 4 Programe Master Shkencor dhe Profesional, konkretisht MSc Inxhinieri Agromjedisi; Msc Menaxhimi i Burimeve Natyrore; MP Menaxhim Mjedisi; MP Zhvillim Rural dhe Mjedisi i Qendrueshëm.</p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p> <p><b>Evidenca 24.1 Personeli akademik dhe ndihmës akademik i DMBN.</b></p> <p><b>Evidenca 43.1. Analiza e punës mësimore kërkimore të DMBN për vitet 2019-2022</b></p> <p><b>Evidenca 56.1 Tabela përmbledhëse, Tabela 5</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Sipas RVB dhe Evidencës 24.1 në këtë department ka 10 punonjës ndihmës akademik. Sipas Tabeles 5 (Evidenca: Tabela përmbledhëse) shpërndarja paraqitet pa ndryshime, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vitin akademik <b>2021-2022</b>: 9 personel Ndhmës Akademik</li> <li>- Viti akademik <b>2022-2023</b>: 10 personel Ndhmës Akademik.</li> </ul> <p>Bazuar në evidencat e paraqitura nga institucioni dhe vizita në institucion, në Dosjen e programit të studimit Bch studentët kryejnë praktika laboratorike në laboratore të FBM si dhe programi i tyre i studimit parashikon praktika në terren dhe në aktivitete të rëndësishme në aspektin e parametrave të mjedisit pranë institucioneve ose bizneseve private.</p> <p>Personeli ndihmës akademik është i përfshirë në mirëmbajtjen dhe drejtimin e punës së laboratorëve dhe praktikës në terren.</p> <p>Evidenca 21.1 paraqet kualifikime të vazhdueshme të personeli ndihmës akademik. Në Evidencën 22.2 paraqiten pajisjet e laboratorit dhe në Evidencën 22.5 paraqiten foto të laboratorit. GVJ ka vizituar këto mjedise dhe ka komunikuar me stafin ndihmës akademik gjatë vizitës në institucion.</p>

	<p><b>Evidenca 21.1 CV e stafit ndihmës akademik</b></p> <p><b>Evidenca 22.2 Pajisjet laboratorike</b></p> <p><b>Evidenca 22.5 Foto të laboratorit</b></p> <p><b>Evidenca 24.1 Personeli akademik dhe ndihmës akademik i DMBN.</b></p> <p><b>Evidenca 56.1 Tabela përmbledhëse, Tabela 5</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion konfirmohet se koordinatori i programit të studimit Bch Manaxhimi i Burimeve Natyrore është përgjegjësi i Departamentit, i cili koordinon dhe monitoron mbarëvajtjen e ecurisë së zhvillimit të mësimin në rolin e koordinatorit të programit dhe kujdeset për ruajtjen e cilësisë dhe mbarëvajtjes së zhvillimit të mësimin në programin e studimit. Në nenin 5 të Rregulloret të Programit specifikohet se duhet të jetë i kategorisë Profesor me 10 vjet përvojë pune. Detyrat përfshijnë lehtësimin, koordinimin, mbarëvajtjen e procesit, zgjidhjen e problemeve dhe realizimin e objektivave të tij. Koordinatorin e programit komunikon me departamentin ku raporton në lidhje me ecurinë e programit.</p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Njësia bazë është e organizuar dhe funksionon në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore lidhur organizimin dhe funksionimin e këtij programi studimi si në numrin e stafit akademik dhe ndihmës akademik, dhe në koordinimin dhe drejtimin e punës së njësisë. Në njësinë bazë është caktuar koordinatori i programit me detyra specifike.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi II.3</b></p> <p><b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë,</p>	<p>Nga dokumentacioni i përcjellë nga institucioni dhe vizita në institucion konstatohet se Departamenti i MBN, si njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bch Manaxhim i Burimeve Natyrore, disponon informacionet e nevojshme</p>



<p>disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Urdhrin e Ministrit për hapjen e programit të studimit 2018 (Evidenca 26.4.1)</li> <li>- Rregullore e programit, me informacion përmbajtjen e programit, objektivat, elementët e tij, kontrollin e dijes, rregullat e studimit, diplomimit, etj (Evidenca 7.1);</li> <li>- Planin strategjik të UBT, ku përfshihet departamenti përgjegjës (Evidenca 3.1);</li> <li>- Program mësimor i ciklit të parë të studimeve Bch MBN, me lëndët e ndara sipas kategorive formuese me kreditet përkatëse, në vite e semestra dhe ngarkesa mësimore sipas veprimtarive formuese të secilës lëndë (Evidenca 14.2);</li> <li>- Programet e çdo lënde (Evidenca 14.1);</li> <li>- CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit, CV-të e personelit akademik (Evidenca: 19.2);</li> <li>- Kuotat dhe kriteret e pranimit në program (Evidenca 14.4);</li> <li>- Formatit dhe Suplementit të diplomës (Evidenca 15.2 dhe 15.3).</li> </ul> <p>GVJ vlerëson se përmbajtja, struktura dhe organizimi i studimeve në programin Bch MBN, janë në përputhje me legjislacionin dhe me aktet nënligjore në fuqi. Nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion konfirmohet se ky informacion është i disponueshëm për studentët dhe bëhet i njohur përmes komunikimit dhe faqes së internetit. Konfirmohet se ndryshimet në programet lëndore, kriteret e pranimit, ngarkesa mësimore e pedagogëve propozohen dhe miratohen strukturave përgjegjëse të UBT.</p>
	<p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 15.2: Suplement i diplomës MBN</b></p> <p><b>Evidenca 15.3: Modeli i diplomës MBN</b></p> <p><b>Evidenca: 19.2: Cv të stafit akademik</b></p>
	<p><b>Evidenca 26.4.1 Urdhrin e Ministrit për hapjen e programit të studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin</b></p>	<p>GVJ konstanton se programi i studimit përmban planin mësimor sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Ai është i</p>




<p>mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>organizuar në lëndë dhe module, sipas semestrave në të tre vitet e studimit. Në planin mësimor përfshihen laboratore dhe seminare si dhe aktivitete formuese.</p> <p>Ndarja e lëndëve dhe moduleve i përgjigjet këtyre kategorive të përcaktuara. Lëndët dhe modulet janë të shpërndarë në 6 semestra, me kredite të specifikuar qartë. Programi ka të përcaktuar Leksionet, Seminare dhe Ushtrime, Laboratore. (Evidenca 14.2 dhe 14.3)</p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.3. Plani mësimor Bch MBN i ndarë sipas veprimtarive formuese.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstanton konfirmon se programi përmban informacionet e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit. Sipas Rregullores së programit të studimit (Evidenca 7.1), jepen kriteret e përgjithshme të pranimit, ndërsa kriteret specifike të pranimit propozohen nga DMBN, dhe miratohen nga strukturat e UBT (Dekanati i FBM dhe Rektorati i UBT).</p> <p>GVJ konstaton se FBM disponon dokumentacionin e nevojshëm për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël brenda UBT ose nga institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Ky proces kryhet në nivel fakulteti. Neni 87 i Rregullores së FBM (Evidenca 6.1) ka të përcaktuar gjithë procedurën që ndiqet për transferimin. Kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve në universitetin pritës janë 30 dhe pranohen kandidatët me rezultatet më të larta.</p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur lidhur me programin lëndor, GVJ konstanton se Programi i studimit përmban programet lëndore për secilën lëndë, përfshirë specifikimet për orët laboratorike. Struktura dhe informacionet e paraqitura në to janë në përputhje me formatin e miratuar (përfshirë përmbajtjen dhe shpërndarjen e temave, mënyrën e vlerësimit, dhe literaturën). Syllabuset përgatiten nga titullari i lëndës në miratohen në njësinë bazë.</p>

<p>gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Formati i Programit të lëndës është në përputhje me elementët e kërkuar, dhe përmban informacion të detajuar lidhur me mënyrën e vlerësimit dhe tematikat (Konceptet kryesore).</p> <p>Në shumicën e programeve të lëndës gjendet literatura e detyruar dhe e rekomanduar. Në disa raste literature e detyruar paraqitet si “Leksioni të përgatitura nga pedagogu”, ndërsa literatura e rekomanduar përmban burime në shqip dhe të huaja.</p> <p>Në disa raste literatura duhet të jetë e specifikuar si literaturë e detyrueshme dhe fakultative. GVJ vëren se ky specifikim mungon për lëndët Menaxhimi Zonave të Mbrojtura, Menaxhimi i Tokës dhe Territorit). Gjithashtu literatura fakultative shpesh është më e vjetër sesa 10-15 vjet dhe e parifreskuar.</p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 19.2. Planet lëndore sipas formatit të kërkuar</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 52.1 mbi procedurën për ndryshimin e kurrikulës, theksohet se ndryshimet bëhen deri në masën 20%.</p> <p>Gjatë takimeve në institucion me stafin akademik dhe përgjegjës është konfirmuar se Programi nuk ka pasur ndryshime prej miratimit të tij nga Ministria, meqë koha është ende e shkurtër dhe e nevojshme për të konsoliduar kurrikulën.</p> <p><b>Evidenca 52.1: Procedura për ndryshimin e kurrikulës</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se dokumentacioni i nevojshëm lidhur me organizimin dhe strukturën e programit është i plotë. Ai referohet në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi sin ë përmbajtje ashtu edhe ne formatin e dokumentacionit të kërkuar. Përmirësimet përmbajtësore dhe të strukturës së programit në vite, nuk ka pasur.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>


**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian**




**të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur dhe shqyrtuar nga GVJ përmban informacion rreth programit të studimit Bch MBN, i cili mundëson mësimin në auditor (leksione, seminare dhe kontrolli i vazhdueshëm) përmes një sërë aktivitetesh.</p> <p>Takimet gjatë vizitës në institucion, në takimet me grupin përfaqësues të studentëve dhe me stafin akademik, konfirmohet ndërveprimi student pedagog për të zhvilluar aftësi të reja dhe nxitur mendimin kritik për çështje të lidhura me mjedisin. Referohet se ky ndërveprim kryhet gjatë procesit mësimor (seminare, konsultime) dhe jashtë tij (bazuar në interesimin e studentëve). Studentët konfirmojnë se ka mundësi punësimi në bizneset private bazuar në njohuritë e fituara gjatë ndjekjes së këtij programi. GVJ konstaton se programi i studimit ndihmon studentët të punësohen kryesisht në tregun e punësimit për ekspertizën mjedisore, menaxhimin mjedisor, bujqësinë, etj.</p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 16.1. Broshura e FBM</b></p> <p><b>Evidenca 17.1. Studimi i tregut të punës</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b>Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në shqyrtimin e Evidencës 14 mbi Programin e Studimit Bch MBN, dhe sylabuset lëndore (Evidenca 19.2) se kurrikula ju mundëson studentëve njohuri dhe aftësi në fushën e mjedisit dhe menaxhimit të tij. Në tërësinë të tij program, mundëson arritjen e objektivit të formimit të specialistëve të rinj mjedisore, kryesisht në fushën e menaxhimit mjedisor. Sipas dosjes së programit, studentët kanë mundësi të fitojnë shprehi dhe aftësi të kërkimit shkencor dhe zbatimit në praktikë të teknikave të matjes së treguesve mjedisorë (biodiversitet, ndotje e ajrit, ujit tokës, etj).</p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 19.2. Planet lëndore sipas formatit të kërkuar</b></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bch MBN ka të përfshirë punë në laborator dhe praktika mësimore në kuadër të lëndëve specifike. Modulet e ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike.</p> <p>Natyra e këtyre praktikave synon të përmbushet bazuar në ofertën prej kompanive private apo edhe të institucioneve dhe agjencive që punojnë në fushën e mjedisit.</p> <p>Studentët nxiten të kryejnë praktika edhe në rajonet e tyre, sikundërse ju ofrohet mundësia e lidhjes me agjenci ose institucione të vetë qeverisjes vendore.</p> <p><i>GVJ vëren se thellimi i praktikës në elemente specifike të lidhura me tregun e punës do të ndihmojë studentët për tu afruar me tregun e punës.</i> UBT ka paraqitur evidencë për marrëveshje të lidhura me institucione të ndryshme për të thelluar kompetencat profesionale. Gjatë vizitës në institucion janë referuar disa bashkëpunime. Në Evidencën 32.1 me 49 institucione të ndryshme (Ministri, bashki, Agjenci, kompani private, etj)</p> <p><b>Evidenca 29.3. Raport vlerësimi_Panairi i karrierës_2022</b></p> <p><b>Evidenca 32.1. Tabelë përmbledhëse e marrveshjeve me institucione të ndryshme</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur ku vëren se ndarja e veprimtarive formuese paraqitet e detajuar në planin mësimor dhe e përcaktuar në sillabuset e lëndëve dhe moduleve. Plani mësimor ka të shprehur qartë ngarkesën mësimore në laborator dhe auditore për formimin teorik dhe praktik të studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se FBM disponon dokumentacionin e nevojshëm për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël brenda UBT ose nga institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Ky proces kryhet në nivel fakulteti. Neni 87 i Rregullores së FBM (Evidenca 6.1) ka të përcaktuar gjithë procedurën që ndiqet për transferimin.</p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se Departamenti ka analizuar çdo vit ecurinë e programit të studimit, përfshirë sillabuset dhe shpërndarjen e ngarkesës sipas moduleve. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion të plotë lidhur me përmbajtjen e lëndës dhe mënyrën e frekuentimit, kontrollit, dhe vlerësimit të dijeve. Çdo program lënde përmban literaturën e detyruar dhe të rekomanduar. Në disa raste literature e detyruar paraqitet si “Leksioni të përgatitura nga pedagogu”, ndërsa literatura e rekomanduar përmban burime në shqip dhe të huaja.</p> <p><i>GVJ vlerëson se duhet specifikuar qartë literatura e detyruar lidhur me emërtimin e ciklit të leksioneve, autorin dhe vitin përkatës. (Kjo mundon në lëndën Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura)</i></p> <p><i>Për literaturën e rekomanduar të referohen edhe faqet e internetit ku mund të aksesohet ose biblioteka e UBT. <u>Sugjerohet që literatura e rekomanduar për disa lëndë, ku lista është mjaft e gjerë, të jetë më e përmbledhur në literaturën e viteve të fundit apo e specifikuar me temat ku ajo ndihmon në zgjerimin e dijeve. Për disa lëndë literatura e detyruar apo e rekomanduar është më e vjetër se sa 10 vite (psh lënda bazat e prodhimit bimor)</u></i></p> <p>GVJ vëren se nuk ka pasur ndryshime në sillabuset dhe programet e lëndëve as deri në masën 20%.</p> <p><b>Evidenca 19.2. Syllabuset e lëndëve.</b></p> <p><b>Evidenca 38.2. Raport i Analizës vjetore 20-21 FBM.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura, GVJ vëren se organizimi i programit të studimit, lëndet e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të parë të studimeve.</p> <p>Bazuar në shqyrtimin e Evidencës 14.2 mbi Programin e Studimit Bch Menaxhimi i Burimeve Natyrore, dhe sillabuset lëndore se kurrikula ju mundëson studentëve njohuri dhe aftësi në fushën e mjedisit. Në tërësinë e tij programi, mundëson arritjen e objektivit të formimit të specialistëve të rinj mjedisore, kryesisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit, fitojnë shprehi dhe aftësi të kërkimit shkencor dhe zbatimit në praktikë të teknikave të matjes së treguesve mjedisorë (biodiversitet, ndotje e ajrit, ujit tokës, etj).</p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p>



	<b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b>			
<b>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</b>	<p>Bazuar në programin Bch MBN, studentët fitojnë njohuritë bazë teorike me aftësi praktike. Ata mundësohen për të vijuar më tej studimet e thelluara në programin e ciklit të dytë të studimeve dhe/ose punësimin në tregun e punës. Gjatë vizitës në institucion janë referuar disa bashkëpunime me biznese dhe institucione në vend (Evidenca 34.1 dhe 34.2). Këto janë shtrirë në vizitat e studentëve në terren apo të agjencie dhe kompanive në mjediset e UBT (organizimi i panairit të punës), për të krijuar mundësi dhe kontakte që ndihmojnë punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve. Vizita në institucion konfirmon se mundësohet punësimi në sektorin publik e privat dhe në institucione të vetqeverisjes lokale apo të menaxhimit mjedisor.</p> <p><b>Evidenca 29.3. Raport vlerësimi panairi 2022</b></p> <p><b>Evidenca 32. Evidenca dhe lista të bashkëpunimeve në Shqipëri dhe Kosovë</b></p> <p><b>Evidenca 33.3. Raport gjurmimi 2021</b></p> <p><b>Evidenca 33.4. Raport gjurmimi 2022</b></p> <p><b>Evidenca 34.1. Marrveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit</b></p> <p><b>Evidenca 34.2 Lista e sipërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve marrveshje me UBT.</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se programi i studimit përmban lëndë që sigurojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve duke ju mundësuar atyre transferimin, thellimin e studimeve apo dhe punësimin në sektorin privat apo publik.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se duhet specifikuar qartë literatura e detyruar për lëndët ku mungon lidhur me emërtimin e ciklit të leksioneve, autorin dhe vitin përkatës, si dhe sugjerohet që literatura e rekomanduar për disa lëndë, ku lista është mjaft e gjerë, të jetë më e përmbledhur në literaturën e viteve të fundit apo e specifikuar me temat ku ajo ndihmon në zgjerimin e dijeve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
		X		

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstanton se përpjekjet për përmirësimin e programit të studimit janë kryer në kuadër të bashkëpunimeve me institucione brenda dhe jashtë vendit, të aktiviteteve trajnuese, etj. Institucioni ka disa bashkëpunime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca 34.1 referon se FBM gjatë vitit 2021 janë realizuar 4 marrveshje të reja bashkëpunimi. Përveç marrveshjeve të reja ka edhe marrveshje të lidhura para vitit 2021 të cilat janë në fuqi pasi kanë fuqi veprimi disa vjeçare. Aktualisht FBM ka aktive 13 marrveshje</p> <p>Për vitin 2022 raportohen 30 marrveshje me kompanini të ndryshme (Evidenca 35.2 fq. 9) dhe 29 marrveshje për zbatim praktikash mësimore (Evidenca 35.2 faqe 10)</p> <p>Gjatë takimeve me stafin akademik në institucion referohet se në kuadër të bashkëpunimeve të shkëmbimeve Erasmus. Në takimin me stafin akademik u referua se shkëmbime të tilla kanë qenë nxitje për ndryshime në programet lëndore apo pasurim i informacionit të dhënë në lëndë specifike dhe tematika të ndryshme.</p> <p>Evidencat 28.1 dhe Evidenca 28.2 paraqesin lëvizje e stafit akademik dhe studentëve në programin Erasmus (23 staf akademik dhe 14 studentë).</p> <p>Për vitin 2022 janë referuar dy leksione të hapura nga pedagogë të huja (Evidenca 38.2)</p> <p><b>Evidenca 28.1. Lista e lëvizjeve të stafit akademik në programin Erasmus.</b></p> <p><b>Evidenca 28.2. Lista e lëvizjeve të studentëve në programin Erasmus</b></p> <p><b>Evidenca 34.1. Marrveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit</b></p> <p><b>Evidenca 34.2 Lista e sipërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve marrveshje me UBT</b></p> <p><b>Evidenca 35.2: UBT_Marrdhënie inst.Publike 2021-2022</b></p> <p><b>Evidenca 38.2: Leksione të hapura</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime</p>	<p>GVJ konfirmon se UBT dhe FBM kanë mekanizma për të nxitur dhe përfshirë në diskutime në kuadër të përmirësimit të</p>

<p>studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>programit të studimit edhe studentët në strukturat e tyre. Gjatë takimit me studentët është referuar se ata pyeten lidhur me opinionin e tyre për ecurinë e programit.</p> <p>Bazuar ne Evidencën 40.2 paraqiten modele anketimi ndërsa Evidenca 40.3 jep rezultatet e anketimit në semestra të ndryshëm. Vizita në institucion konfirmon se studentët janë pyetur përmes përfaqësuesve të tyre apo edhe përmes pyetësorëve. Përfshirja e studentëve në përmirësimin e kurrikulës sugjerohet të jetë më e strukturuar dhe e vazhduar, duke vlerësuar edhe efektivitetin e programit për njohuritë e pritshme në tregun e punës.</p> <p><b>Evidenca 40.2. Model anketimi.</b></p> <p><b>Evidenca 40.3. Rezultatet e anketimit sipas semestrave</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur prej institucionit dhe diskutimet gjatë vizitës në institucion konfirmojnë se FBM ka bënë vëmendje përditësimin e programit në përputhje me zhvillimet strategjike të vendit. Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët u theksua se tregu i punës ka qenë një faktor ndikues shumë i fortë për të krijuar drejtime të reja për mjedisin dhe menaxhimin e burimeve natyrore.</p> <p>Për shkak të kohës së shkurtër nuk ka pasur ndryshime të propozuara dhe miratuara në programin e studimit dhe kurrikulën e tij.</p> <p><b>Evidenca 38.3. Analiza e punës mësimore FBM 2020-2021</b></p> <p><b>Evidenca 40.3. Analiza e punës mësimore 2021</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se stafi i njësisë bazë përgjegjëse për këtë program ka bërë përpjekjet e duhura për të mbajtur në vëmendje përmirësimin e programit me një pjesëmarrje të gjerë, duke përfshirë stafin akademik dhe studentët. Bashkëpunimet e kompani dhe sipërmarrës private, të cilët kanë interes për fuqi punëtore të kualifikuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit ka ndihmuar në adresimin e nevojave të tregut me specialistë të fushës së menaxhimit të burimeve natyrore dhe mjedisit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në dosjen e programit dhe syllabuset e lëndëve, GVJ vëren se mësimdhënia dhe transmetimi i njohurive në këtë program realizohet përmes formave të ndryshme si: leksione, seminare, laboratore, detyra kursi, dhe praktika në terren, bazuar në strukturën e planit mësimor vjetor të aprovuar nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) këto elemente, përfshirë përdorimin e teknikave digjitale u referuan nga stafi akademik dhe studentët. GVJ konstaton se mjetet dhe pajisjet mundësojnë këto forma gjatë vizitës në mjediset e institucionit.</p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ diskutoi me përfaqësues të stafit akademik dhe studentët të cilët referuan se përdoren metoda alternative të mësimdhënies, bazuar në specifikat e lëndës që zhvillohet dhe aftësive të studentëve. Referohet se personeli akademik organizon orën mësimore duke alternuar aspektin teorik me atë praktik duke aktivizuar studentët me diskutimet e tyre (Evidenca 40.3).</p> <p>Studentët pjesëmarrës në takim referuan se kanë mundësi të marrin pjesë në konsultimet e përcaktuara nga personeli akademik për përvetësimin sa më mirë të njohurive të marra.</p> <p><b>Evidenca 38.3. Analiza e punës mësimore FBM 2020-2021</b></p> <p><b>Evidenca 40.3. Analiza e punës mësimore 2021.</b></p> <p><b>Evidenca 47.2. Ëëbsite i pedagogut.</b></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon pajisjen e mjediseve të zhvillimit të mësimin me teknologji digjitale. Shkëmbimet në kuadër të programit Erasmus kanë ndihmuar personelin akademik në aspektin didaktik dhe në përdorimin e një teknologjie që mundëson lehtësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Nga takimi me studentët GVJ konfirmon se UBT/FBM përmbush nevojat me pajisje dhe bazë materiale të nevojshme për zhvillim dhe përmirësimin cilësor të mësimdhënies. Vizita në mjediset laboratorike (DAME dhe Lab shkencor) konfirmon pajisjen e tyre me mjete dhe pajisje për zhvillimin e orëve mësimore, kërkimore-shkencore, etj.</p> <p><b>Evidenca 28.1. Lista e lëvizjeve të stafit akademik në programin Erasmus.</b></p> <p><b>Evidenca 38.3. Analiza e punës mësimore FBM 2020-2021</b></p> <p><b>Evidenca 40.3. Analiza e punës mësimore 2021.</b></p> <p><b>Evidenca 42.6: Kapacitete të UBT</b></p> <p><b>Evidenca 46 (1, 2, 3). Manuale shpjeguese për ëbsite dhe komunikim digjital</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar evidencat lidhur me kualifikimin e stafit akademik (Evidence 20.1: CV të stafit akademik) dhe konfirmon se ai është i kualifikuar dhe me përvojë në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor, në përputhje me realizimin e objektivave në përgatitjen e specialistëve të ardhshëm në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore dhe mjedisit.</p> <p>Mundësitë e përfshirjes në mobilitete apo kërkimin shkencor mundëson rritjen e kompetencave të personelit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin akademik kishte të pranishëm edhe staf akademik të fakulteteve të tjera të UBT, i cili konfirmoi për GVJ se stafi akademik që ka qenë i përfshirë ka kualifikimet e nevojshme për të përmbushur objektivat e këtij program studimi.</p> <p><b>Evidenca 20.1. Curriculum Vitale e stafit akademik.</b></p> <p><b>Evidenca 56.5. Tabelë përmbledhëse 12.3 për angazhimin e personelit akademik për vitin 2021-2022.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit,</p>	<p>GVJ konfirmoi gjatë vizitës në institucion (Takimi me studentët) se studentët janë pjesë integrale e vlerësimit lidhur me mësimdhënien. Janë përdorur instrumenta të ndryshëm</p>



<p>vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>kryesisht pyetësorë që lidhen me vlerësimin e studentëve dhe punës së fakultetit dhe të departamentit. U referua nga studentët dhe stafi akademik se Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë kanë zhvilluar anketime me studentët rreth vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës apo mënyrës së të mësuarit.</p> <p>GVJ u informua se studentët kanë të drejtën e ankimit sipas rregullores përkatëse në rastet kur kanë pretendime për notën, vlerësimin e nga pedagogu apo dhe rishikim të tezave të provimit etj. Por raste të tilla nuk u referuan nga takimi me studentët dhe stafin akademik.</p> <p><b>Evidenca 12.2. Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.</b></p> <p><b>Evidenca 40.1. Model pyetësori i FBM</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ evidentoi përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion (Takimi me kordinatorin e programit dhe stafin akademik) se UBT ka në përbërje të saj strukturë për cilësinë (DVBSC) me funksion koordinimin institucional, vlerësimin e cilësisë dhe të performancës (Takimi me përfaqësuesit e kësaj njësie). Struktura ka organizuar aktivitete të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen personelit akademik. Gjithashtu Drejtoria e Shërbimeve Mësimore mbështet procesin mësimor, stafin akademik dhe studentët me informacion lidhur me procesin mësimor, orëve të hapura, veprimtarive të ndryshme në nivel Universiteti dhe Departamenti (DMBN) përfshirë organizimin e aktiviteteve të ndryshme informuese dhe njohëse për programin Erasmus+, trajnime, panaire punësimi, etj.</p> <p>Vetë DMBN ka marrë nismën e veprimtarive mësimore dhe shkencore që ndihmojnë pasurimin e njohurive dhe programit mësimor dhe kërkimor, ku përfshihen edhe studentët.</p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 12.2. Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë</b></p> <p><b>Evidenca 23.1. Organograma e UBT dhe FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 38.2: Leksione të hapura</b></p> <p><b>Evidenca 40.3. Analiza e punës mësimore 2021</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson pajisjen e mjediseve të mësimdhënies me teknologji digjitale që mundëson dhënien e njohurive me</i></p>

	teknika të reja. Bashkëpunimi në kuadër të programeve Erasmus ka mundësuar zhvillimin e institucionit dhe stafit akademik në këtë drejtim.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në evidencat e paraqitura, kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e Studimeve në UBT, FBM dhe Departamentit të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët), konfirmohet praktika se vlerësimi është me provime dhe i ndërmjetëm. Provimet realizohen me shkrim dhe studentët njihen me rezultatin përmes shpalljes nga pedagogët dhe mund të shohin korrigjimin. Dokumentacioni dhe rregulloret për vlerësimin janë të botuara në faqet e internetit të institucionit.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve universitare në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.6. Mënyra e vlerësimit të dijeve.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konfirmon përmes vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik) dhe bisedës me studentët se në fillim të çdo semestri, sipas rregullores së FBM dhe të Departamentit MBN, titullari i lëndës bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, njeh studentët me objektivat dhe temat kryesore të saj si dhe elementët e tjerë të sillabusit (format e kontrollit të dijës dhe frekuentimin, literaturën që do të përdoret etj.)</p> <p>GVJ konfirmon se informacioni mbi programet lëndore është i afishuar në faqen e internetit të UBT. Gjithashtu, në takimin me drejtuesit e njësisë dhe stafin akademik konfirmohet se programet janë të botuara edhe në faqet e ëeb të cdo pedagogu. Pedagogët organizojnë konsultime lëndore të njoftuara për</p>



	<p>studentët. Bazuar ne evidencën e programeve lëndore, GVJ konfirmon se modeli i vlerësimit me provim është i përcaktuar në silabuset lëndore.</p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p> <p><b>Evidenca 47.1. Struktura e website të UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 47.2. Website i pedagogut</b></p> <p><b>Evidenca 47.5. Linqe informuese.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ ka konfirmuar përmes vizitës në institucion dhe dokumentacionit të paraqitur (Rregullore e programit të studimit) se ka rregullore ku janë përcaktuar format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar studenti gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës Vlerësimi është i vazhduar dhe/ose provim përfundimtar.</p> <p>Studentët dhe pedagogët konfirmojnë se testimi i ndërmjetëm organizohen në javët e planifikuara të çdo semestri në përputhje me planifikimin e bërë në sillabusin e lëndës e në varësi të këtij të fundit. Studentët konfirmojnë se kanë detyra kursit dhe projekte që punohen individualisht ose në grup në varësi të lëndës.</p> <p>Sipas dokumentacionit, provimi përfundimtar organizohet me shkrim. Gjatë vizitës në institucion u referua se zbatohet kryesisht provimi me shkrim. GVJ konfirmon nga takimi me drejtuesit e njësisë se grafiku i provimeve miratohet nga Dekani. Ai shpallet para fillimit të sezonit të provimeve. Në formën e vlerësimit përfundimtar përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit konvertohet në notë.</p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN.</b></p> <p><b>Evidenca 14.6. Mënyra e vlerësimit të dijeve.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë</p>	<p>GVJ konfirmoi gjatë vizitës në institucion (Takimi me studentët) se studentët janë pjesë integrale e vlerësimit lidhur me mësimdhënien. Janë përdorur instrumenta të ndryshëm kryesisht pyetësorë që lidhen me vlerësimin e studentëve dhe punës së fakultetit dhe të departamentit. U referua nga studentët dhe stafi akademik se Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe</p>


<p>studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sigurimit të Cilësisë kanë zhvilluar anketime me studentët rreth vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës apo mënyrës së të mësuarit.</p> <p>GVJ u informua se studentët kanë të drejtën e ankimit sipas rregullores përkatëse në rastet kur kanë pretendime për notën, vlerësimin e nga pedagogu apo dhe rishikim të tezave të provimit etj. Por raste të tilla nuk u referuan nga takimi me studentët dhe stafin akademik.</p> <p><b>Evidenca 12.2. Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.</b></p> <p><b>Evidenca 40.1. Model pyetësori i FBM</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ diskutoi me përfaqësues të stafit akademik dhe studentët të cilët referuan se përdoren metoda alternative të mësimdhënies, bazuar në specifikat e lëndës që zhvillohet dhe aftësive të studentëve. Referohet se personeli akademik organizon orën mësimore duke alternuar aspektin teorik me atë praktik duke aktivizuar studentët me diskutimet e tyre (Evidenca 40.3).</p> <p>Studentët pjesëmarrës në takim referuan se kanë mundësi të marrin pjesë në konsultimet e përcaktuara nga personeli akademik për përvetësimin sa më mirë të njohurive të marra.</p> <p>Leksionet e hapura dhe shkëmbimet në programin Erasmus kanë ndihmuar në perfeksionimin e metodave të reja në mësimdhënie dhe angazhimin e studentëve në krijimin e shprehive të autonomisë akademike dhe studimit të pavarur.</p> <p><b>Evidenca 38.2: Leksione të hapura</b></p> <p><b>Evidenca 38.3. Analiza e punës mësimore FBM 2020-2021</b></p> <p><b>Evidenca 40.3. Analiza e punës mësimore 2021.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson përmbushjen e standardit si në rregullimin e procesit të vlerësimit ashtu edhe në kryerjen e tij gjatë procesit mësimor me anë të vlerësimit të vazhduar apo atij përfundimtar</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi III.3**


**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore është njësia bazë përgjegjëse për procesin e monitorimit të vlerësimit. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë, ai organizon dhe ndjek procesin e vlerësimit të dijeve që bëhet gjatë gjithë semestrit ku zhvillohet lënda/moduli duke respektuar përcaktimet ligjore dhe aktet rregullatore të UBT dhe FBM-së. Sistemi i vlerësimit të dijeve është me 10 nota, e paraqitur kjo dhe në programin lëndor sipas kualifikimit të pikëve të fituara. GVJ konfirmon nga takimi me studentët në institucion se pedagogu njofton studentët për vlerësimin në fillim të vitit të ri akademik.</p> <p>Studentët dhe pedagogët konfirmojnë se testimi i ndërmjetëm organizohen në javët e planifikuara të çdo semestri në përputhje me planifikimin e bërë në sillabusin e lëndës e në varësi të këtij të fundit. Studentët konfirmojnë se kanë detyra kursit dhe projekte që punohen individualisht ose në grup në varësi të lëndës. Gjatë vizitës (Takimi me studentët) konfirmohet angazhimi i studentit me detyra të ndryshme që ndihmojnë pedagogun për një vlerësim sa më të saktë të njohurive të fituara.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve universitare në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.6. Mënyra e vlerësimit të dijeve.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konfirmon se UBT nuk zbaton ndonjë sistem të automatizuar të korigjimit të provimeve. Teza e provimit është e hartuar nga pedagogu me pyetje me alternativa ose shtjellim në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më korrekt.</p> <p>Në sistemin elektronik Pitagora të UBT-së, hidhen rezultatet e vlerësimit përfundimtar, duke informuar studentët në kohë reale për rezultatet e tyre. Gjatë vizitës në institucion studentët referojnë se njihen me notat edhe drejtpërdrejt nga pedagogët e lëndës.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve universitare në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p>Bazuar në informacionin e mbledhur gjatë vizitës në institucion, konfirmohet se komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe i përcillet për dijeni dekanatit të fakultetit dhe sekretarisë mësimore. Takimi me koordinatorin dhe stafin akademik konfirmon se komisioni i provimit ka 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit, ndërsa anëtari tjetër ka të njëjtin profil ose të përafërt me të parin.</p> <p>Tezat e provimit rinovohen çdo vit akademik dhe firmosen nga drejtuesi i njesisë bazë para zhvillimit të provimit. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ vëren se sylabuset përmbajnë informacionin mbi shpërndarjen e vlerësimit në atë të vazhdueshëm përmes seminareve dhe pjesëmarrjes dhe atij përfundimtar përmes provimit të lëndës.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve universitare në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ ka verifikuar dhe konfirmuar gjatë vizitës në institucion se ndodh mbështetja e studentëve gjatë procesit të vlerësimit të vazhduar të elementëve të një moduli/lënde si seminare, detyra e kursit/projekte, ku stafi akademik bën komente specifike së lëndës gjatë korigjimit në fletore, në rrugë elektronike ose në komunikim të drejtpërdrejtë.</p> <p>Studentët kanë konfirmuar gjatë vizitës në institucion se ndihmohen në përmirësimin e njohurive dhe sqarimin e paqartësive. Pas korigjimit të provimeve, studentët kanë një periudhë ankimi pasi janë njohur me rezultatin e provimit bazuar në rregulloren e studimeve në FBM.</p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.6. Mënyra e vlerësimit të dijeve.</b></p> <p><b>Evidenca 40.1. Model pyetësori i FBM</b></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur në trajtën e evidencave (Analiza e punës mësimore) konfirmon se Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore dhe stafi akademik zbatojnë kriteret për realizimin e provimeve dhe detyrave sipas rregullores së UBT, FBM, dhe Kodin e Etikës, sidomos e lidhur me kopjimin në provime dhe detyra. Kryesisht kjo realizohet përmes kontrollit prej pedagogëve për punimet e studentëve.</p> <p><i>GVJ vëren se nuk ka ndonjë mekanizëm kontrolli lidhur me plagjiaturën në punimet e studentëve. Ky element është referuar edhe gjatë vizitës në institucion.</i></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 5.2. Rregullore e Këshillit të Etikës UBT</b></p> <p><b>Evidenca 40.3. Analiza e punës mësimore 2021</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitur (Rregullore e Programit të Studimit - Evidenca 7.1), rezultatet e vlerësimit final që paraqesin kontrollin e dijeve dhe aftësive të studentit iu bëhen të ditur në sistemin elektronik Pitagora. Sistemi Pitagora udhëhiqet nga disa parime që garantojnë konfidencialitetin e të dhënave personale.</p> <p>GVJ nuk ka marrë referime gjatë vizitës në institucion për problematika në njoftimin e rezultateve të provimit prej studentëve (Takimi me studentët dhe me stafin akademik).</p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 46.1. Manual për studentin për sistemin Pitagora</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion është referuar se vlerësimet hidhen në sistemin Pitagora, dhe iu jepen studentëve direkt nga pedagogu i lëndës, dhe studenti mund të shohë vlerësimin dhe mund të ankimojë.</p> <p>Pas shpalljes së rezultateve dhe hedhjes së tyre në sistemin Pitagora, studenti ka të drejtë të ballafaqohet dhe të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve. Takimi me stafin akademik dhe studentët konfirmon se komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e provimit. Pas këtij afati,</p>




	<p>nota konsiderohet perfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të proces-verbalit në sistem.</p> <p>Provimet përgjithësisht realizohen me shkrim (bazuar në informacionin nga vizita në institucion me studentët dhe stafin akademik) dhe ruhen për 6 muaj. GVJ nuk ka marrë referime gjatë vizitës në institucion për problematika në njoftimin e rezultateve të provimit prej studentëve.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve universitare në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN.</b></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas evidencave të paraqitura dhe konfirmuar prej vizitës në institucion, praktika e ndjekur është që kur studenti mendon se janë shkelur rregullat procedurale të zhvillimit të provimit, ai ka të drejtë të bëjë ankimim me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit duke iu drejtuar Dekanit.</p> <p>Dekani shqyrton ankesën, thërret palët për sqarime dhe merr vendimin. Nëse vendimi ka të bëjë më ridhënien e provimit ngrihet një komision i ri.</p> <p>GVJ nuk ka marrë referime gjatë vizitës në institucion për problematika në ankimin e rezultateve të provimit prej studentëve.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve universitare në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson së institucioni përmbush këtë standard për të gjitha kriteret e vendosura për organizimin, njoftimin dhe trajtimin e ankesave lidhur me vlerësimin e njohurive të studentit.</i></p> <p><i>GVJ vëren se nuk ka ndonjë mekanizëm kontrolli lidhur me plagjiaturën në punimet e studentëve, i cili duhet vlerësuar sidomos për temat dhe punimet përmbyllëse në ciklin e studimeve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Evidencat e paraqitura (Programi i studimit dhe Programet lëndore) mbështesin vlerësimin se ky program synon pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe përgatitjen e specialistëve të mjedisit.</p> <p>Në mbështetje të kësaj, është organizimi i lëndëve në 5 kategori, nga A në F. Tematika e lëndëve është e specializuar në drejtime të veçanta mjedisi dhe Burimet Natyrore ku studentët mund të specializohen për drejtime të ndryshme të tregut të punës. Gjetjet nga vizita në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) konfirmojnë kombinimin e njohurive teorike me ato praktike.</p> <p>GVJ vëren se praktikat jashtë universitetit në institucione dhe agjenci të fushës përforcojnë më tej këto njohuri dhe lidhnin studentin drejtpërdrejt me tregun e punës. Vlerësimi i tyre përmes temës së paraqitur ndihmon në angazhimin e studentëve në këto aktivitete për thellimin e njohurive.</p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 34.1. Marrvëshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit</b></p> <p><b>Evidenca 34.2 Lista e sipërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve marrvëshje me UBT</b></p> <p><b>Evidenca 35.2: UBT_Marrdhënie inst.Publike 2021-2022</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Evidencat e paraqitura (Evidenca 14.2) konfirmojnë se programi i studimit nxit zhvillimin e studentit përtej fushave të mirëfillta mjedisore dhe burimet natyrore përmes prezantimit të detyrave, projekteve, temave të diplomës. Gjatë vizitës në institucion studentët referuan përfshirjen në panaire, me punime individuale ose në grup, duke nxitur formimin me të gjerë human dhe social të tyre në drejtim të komunikimit dhe ndërlidhjes me fusha të tjera.</p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p>

	<p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 52.1. Procedura për ndryshimin e kurrikulës</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Evidencat e paraqitura (Planet mësimore 14.2) dhe diskutimet gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik) konfirmojnë vlerësimin e programeve lëndore dhe kurrikulës në mënyrë periodike. Ato hartohen nga pedagogu i lëndës në të cilën përfshihen aftësitë dhe kompetencat që ai kërkon të ndërtojë tek studimi.</p> <p>Rishikimi përmbajtësor i lëndëve, përveç shpërndarjes së krediteve dhe kryerjes së tyre në semestral të ndryshëm, afron më shumë kompetencat që fiton studenti me ato që kërkon tregu i punës. Studentët kanë konfirmuar se pedagogët orientojnë studentët në përmbushjen e këtyre kompetencave të synuara. Hartimi i një punimi si temë përmbyllëse dhe mbrojtja përpara një komisioni ndihmon në prezantimin e njohurive dhe kompetencave të fituara, si detyrime përmbyllëse.</p> <p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 53.1. Praktikat profesionale</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e</p>	<p>GVJ vëren se përbërja e kurrikulës së programit të studimit sipas lëndëve dhe modulet që e përbëjnë atë është ndërtuar në mënyrë të tillë që tu japë studentëve kompetenca dhe aftësi që u përgjigjen kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Lëndët e programit janë të larmishme duke e bërë kurrikulën e programit të studimit të përshtatshme për të nxjerrë specialist të menaxhimit të burimeve natyrore dhe mjedisit. Referohen se përdoren metoda të ndryshme në transmetimin e njohurive që kanë si synim zhvillimin njohës dhe profesional të studentëve. Këto metoda konsistojnë në nxitjen e bashkëpunimit, diskutimit, punës në grup si dhe në krijimin e bashkëpunimit ndërinstitutional profesional dhe edukativ.</p> <p>Kontribut japin edhe Lab. Shkencor i Mjedisit, Lab i Tokave ku studentët mund të aftësohen në praktika vlerësimi dhe monitorimi. Vizita në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) konfirmon zhvillimin e praktikave dhe vizitave në institucione të ndryshme i jep mundësi studentëve të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e mjedisit, cilësisë së ajrit, ujit, ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve. Evidencat konfirmojnë se DMBN ka krijuar bashkëpunime me</p>






<p>mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>institucione të ndryshme Brenda bvendit dhe jashtë për të rritur mobilitetin e studentëve në kuadër të programit Erasmus.</p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 28.2. Lista e lëvizjeve të studentëve në programin Erasmus Evidenca 34.1. Marrveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit</b></p> <p><b>Evidenca 34.2 Lista e sipërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve marrveshje me UBT</b></p> <p><b>Evidenca 35.2: UBT_Marrdhënie inst.Publike 2021-2022</b></p> <p><b>Evidenca 53.1. Praktikat profesionale</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) referohen aktivitete me studentë, kryesisht nga lektorë të huaj ose përfaqësues të institucioneve e kompanive të rajonit në formën e orëve të hapura mësimore. Disa nga këto takime janë organizuar në kuadër të shkëmbimeve të Programit Erasmus (Evidenca 38.1).</p> <p>Raportet e ecurisë së procesit mësimor dhe kërkimor japin në mënyrë të detajuar ecurinë e botimeve të kryera nga stafi akademik sipas viteteve të ndryshme, që tregojnë për një ecuri të mirë në këtë drejtim me 577 artikuj te botuar dhe 3601 citime (Evidenca 43.1.3 fq. 8)</p> <p><b>Evidenca 38.2: Leksione të hapura</b></p> <p><b>Evidenca 43.1.3. Analiza e punës mësimore 2022 të DMBN</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson përpjekjen e njësisë bazë për të rritur kompetencat e studentëve që vijojnë në këtë program studimi duke përdorur element të teknologjisë së informacionit dhe përfshirjen në punë shkencore dhe kërkimore. GVJ vëren se përfshirja e studentëve bëhet e lidhur me efektivitetin e përdorimit të laboratorëve apo bashkëpunimeve me institucione të tjera për të zhvilluar kërkim shkencor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Rregullorja e programit dhe dokumentacioni tjetër mbështetës konfirmojnë se institucioni ka një procedurë të qartë për të fituar diplomën për programin e këtij studimi. Çdo student duhet të ketë grumbulluar numrin e krediteve të përcaktuara për këtë program studimi. GVJ ka konfirmuar këtë praktikë edhe gjatë vizitës në institucion (Takimi në sekretarinë mësimore).</p> <p>Në fund të programit në ciklin e parë të studimit Menaxhim i Burimeve Natyrore studenti mbron punimin e temës, për të cilën ndiqet dhe mbështetet nga një pedagog i programit, pas realizimit të praktikës mësimore, sipas formatit të përcaktuar të punimit.</p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konfirmon nga takimi në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) se stafi akademik informon studentët lidhur me kriteret e diplomimit. Ai informon studentët për udhëzime apo materiale të tjera lidhur me përgatitjen për realizimin e punës së diplomës. Ky material është i botuar edhe në faqen e internetit të institucionit.</p> <p>Evidenca 14.9 përshkruan mënyrën e përgatitjes dhe kriteret për punimin e diplomës. Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës. Gjatë vizitës në institucion nuk janë referuar problematika nga studentët për këtë çështje. Studentët që zgjedhin të japin provimin përfundimtar, në varësi të notës mestare të arritur, e bëjnë provimin e formimit me shkrim, në bazë të udhëzimeve të pedagogëve për çështjet më të rëndësishme të trajtuara në leksione.</p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.9 Udhëzim për mikrotezën DMBN.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit dhe vizitën në institucion (Takimi me koordinatorin e programit) konfirmohet se komisioni i diplomës propozohet nga Përgjegjësi i Departamenti dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Ky</p>



<p>gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>komision është i përbërë nga dy anëtarë të stafit akademik i cili është angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi.</p> <p>Në mënyrë të ngjashme studentët që zgjedhin të japin provimin përfundimtar, në varësi të notës mestare të arritur, e bëjnë provimin e formimit me shkrim, në bazë të udhëzimeve të pedagogëve për çështjet më të rëndësishme të trajtuara në leksione.</p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion konfirmohet se temat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin ato, përcaktohen nga DMBN. Studenti duhet të ndjekë manualin e punimit dhe formatin e diplomës. GVJ konfirmon nga takimi me stafin akademik se udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përgatitjen e temës së diplomës sipas rregullores së FBM. Punimi i diplomës bëhet pas praktikës në institucione jashtë UBT ose edhe prane Lab. DAME nëse ka lidhje me analizim të mostrave të ujit, tokës, etj. Gjatë vizitës në institucion nuk janë referuar problematika nga studentët për këtë çështje.</p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.9 Udhëzim për mikrotezën DMBN</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Evidenca 42.3 dhe vizita në institucion konfirmojnë ekzistencën e laboratorëve në UBT / FBM që mbështesin studentët e programit të studimit në Bch MBN me pajisjeve të nevojshme të vëna në dispozicion për kryerjen e studimeve. Në DMBN është edhe Lab. LAME, është në funksion të kërkimit shkencor me pajisjet e nevojshme për analizimin e parametrave të ujit, ahjrit dhe tokës. Vizita në këtë Laborator konfirmon pajisjen e plotë të tij dhe mundësitë e përfshirje së studentëve në tematika shkencore kur është e nevojshme. UBTT ka edhe Fermën Didaktike Eksperimentale (FDE), ku mund të kryhen eksperimente të thjeshta kërkimore duke përfshirë edhe studentë.</p> <p><b>Evidenca 22.2. Listë e pajisjeve</b></p> <p><b>Evidenca 22.5. Foto laborator</b></p> <p><b>Evidenca 42.1. Raport i ekspertit për infrastrukturën</b></p>

	<b>Evidenca 42.3. Planvendosje e laboratorit shkencor</b>			
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Takimi në institucion me stafin akademik konfirmon se mbrojtja e punimit të diplomës bëhet para një komisioni prej 3 anëtarësh, ku njëri është dhe oponent. Ngritja e komisionit bëhet nga Dekani. Në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës studenti vlerësohet me notë. Vlerësimi i punimit të diplomës pasqyrohet në proces-verbalin përkatës dhe në sistemin e menaxhimit të të dhënave.			
	<b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b>			
	<b>Evidenca 15. Modelet e diplomave</b>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ konfirmon se studentët që kanë pëmbushur të gjitha detyrimet e programit të këtij cikli studimi dhe detyrimet e tjera financiare ndaj institucionit përkatës pajisen me diplomë shoqëruar me suplementin e saj. Diploma e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bch MBN shoqërohet me listën e plotë të notave dhe me suplementin e saj.			
	<b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b>			
	<b>Evidenca 15.1. Urdhër për regjistrimin e formave të diplomave</b>			
	<b>Evidenca 15.3. Format i diplomës.</b>			
	<b>Evidenca 15.2. Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit.</b>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Gjatë vizitës në institucion (Takimi në sekretarinë mësimore), GVJ konfirmon se UBT ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të çdo studenti. Dhënia dhe marrja në dorëzim e dokumentave bëhet kundrejt firmave. Regjistrat dhe dosjet ruhen në sekretari dhe arkivë.			
	<b>Evidenca 9.2. Draft Rregullore e DSHMK.</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se institucioni ndjek dhe përmbush procedurën përmbyllëse të studimeve si në aspektin organizativ ashtu edhe atë të dokumentacionit të dorëzuar studentit apo të arkivuar në institucion.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1


Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në kualifikimet dhe CV-të e paraqitura (Evidenca 20.1), personeli akademik me kohë të plotë, i angazhuar në programin e studimit Bch MBN, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, duke patur grada/tituj akademikë.</p> <p>Në vijim paraqiten të dhënat për personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi për tre vite akademike: (Tabelat përmbledhëse: Tab. 4.1; 4.2;4.3):</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2022 - 2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>12</td> <td>0</td> <td>12</td> <td>0</td> <td>12</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>8</td> <td>0</td> <td>9</td> <td>0</td> <td>9</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>9</td> <td>0</td> <td>8</td> <td>0</td> <td>8</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td><b>30</b></td> <td><b>0</b></td> <td><b>30</b></td> <td><b>0</b></td> <td><b>30</b></td> <td><b>0</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Fushat e studimit janë konform fushës kërkimore të personelit akademik të përfshirë. Personeli akademik është i angazhuar në 7 Programe studimit: 2 Bch, 2 Master Shkencor, 2 Master professional dhe 1 program të ciklit të 3-të</p> <p>Shqyrtimi i elementit Titullar lëndë/Lektor, konfirmon se të gjithë titullarët përmbushin kriterin për të pasur titullin Dr. si lektorë. (Evidenca 14.1)</p>	Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	12	0	12	0	12	0	Prof.As.Dr	8	0	9	0	9	0	Dr/PhD	9	0	8	0	8	0	Msc	1	0	1	0	1	0	Në total	<b>30</b>	<b>0</b>	<b>30</b>	<b>0</b>	<b>30</b>	<b>0</b>
Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023																																												
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																											
Prof.Dr	12	0	12	0	12	0																																											
Prof.As.Dr	8	0	9	0	9	0																																											
Dr/PhD	9	0	8	0	8	0																																											
Msc	1	0	1	0	1	0																																											
Në total	<b>30</b>	<b>0</b>	<b>30</b>	<b>0</b>	<b>30</b>	<b>0</b>																																											

	<p><b>Evidenca 14.1: Kurrikula e programit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 14.2. Planet mësimore të programit të studimit Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 20.1. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</b></p> <p><b>Evidenca 20.1. Curriculum Vitae e stafit akademik dhe ndihmës akademik.</b></p> <p><b>Evidenca 56.1. Tabelat përmbledhëse: Tab. 2, tab. 5</b></p>
<p><b>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</b></p>	<p>Bazuar në të dhënat e përcjella nga UBT (tabelat 56.5), mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë për vitin 2021-2022 paraqitet si në vijim:</p> <p>Për sa më lart, ngarkesa mësimore mbulohet të paktën 70% nga personeli akademik efektiv.</p> <p>Lidhur me ngarkesën e lëndëve, GVJ vëren se jo të gjithë anëtarët e personelit të përfshirë përmbushin kriteret e Udhëzimit 29/2018, i ndryshuar, duke mbuluar:</p> <p>S.s – 9 lëndë; E.D – 8 lëndë; V.B – 7 lëndë</p> <p>Bazuar në evidencat e paraqitura (tabela 56.5) ngarkesa mësimore e këtij programi të studimit është ndarë midis anëtarëve efektivë të DMBN si dhe 3 anëtarëve me kontratë.</p> <p>Stafi akademik PAE përmbush kërkesat për ngarkesën e kryer në këtë program për të mbuluar më shumë se 70% të orëve të programit në auditor.</p> <p>Shqyrtimi i ngarkesës së përgjithshme për çdo lektor në këtë program (Evidencë: Tabelat përmbledhëse, tabela 56.5), tregon se ai është brenda kufijve të përcaktuar për mësimin në auditor si normativës së lidhur me titullin dhe orëve jashtë auditorit. Përsa i përket ngarkesës në orë mësimore në total, për të gjitha programet e studimit, paraqitet një ngarkesë që varion brenda normës së përcaktuar me ndonjë lëvizje të vogël si vijon:</p> <p>J.K mbi normën e përcaktuar të maksimumit të orëve shtesë (25 orë)</p> <p>V.B mbi normën e përcaktuar të maksimumit të orëve shtesë (25 orë)</p> <p>Në ngarkesën për vitin 2021-2022 nuk janë të shënuar emrat e pedagogët e ftuar.</p> <p><b>Evidenca 56.5: Ngarkesa mësimore 2021-2022.</b></p>
<p><b>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të</b></p>	<p>Nga evidencat e paraqitura në formë tabelare (tabela 56.3 deri 56.5) dhe deklarimi në CV e stafit akademik tregojnë për</p>

<p>dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>qendrueshmëri të stafit prej një periudhe të gjatë. Stafit akademik në programin studimor është me përvojë të gjatë në të njëjtin pozicion mësimdhënës. Përmes kontratave të punës, të verifikuara në institucion, UBT dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit për të gjithë periudhën e akreditimit.</p> <p><b>Evidenca 56.3-4-5: Ngarkesa mësimore 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</b></p> <p><b>Evidenca 20.1. CV stafi</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 11.2 për rregulloret e institucionit për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik, UBT ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike në varësi të kërkesës e nevojës së departamentit.</p> <p>GVJ konfirmon nga vizita në institucion (Takim në zyrën e personelit) se kërkesa paraqitet nga DMBN si njësi bazë dhe miratohet në dekanat. Njoftimet publikohen në faqen e internetit të UBT me kërkesa specifike për nivelin e duhur të kualifikimit dhe sipas nevojës në programin e studimit. Konfirmohet se kriteret e përgjithshme janë nota mesatare, profili i studimit. Ndërsa ato specifike janë grada dhe tituj akademik që ka fituar brenda dhe jashtë vendit, përvojën e punës, njohuri të gjuhëve të huaja, aktivitetin shkencor etj. Procedura e vlerësimit të kandidatëve është e përcaktuar në rregulloren e rekrutimit të personelit akademik. Komisioni i vlerësimi Ad Hoc me 5 anëtarë (fq 4 Evidenca 11.2) bën vlerësimin me pikë sipas formularëve në anekset e rregullores. Aplikuesit mund të ankimojnë pas shpalljes së rezultatit.</p> <p><b>Evidenca 11.2. Rregullore e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 11.3. Vendim senati për rekrutimin e personelit akademik</b></p> <p><b>Evidenca 44.2. Formatit i publikimit të ofertës për vend pune</b></p> <p><b>Evidenca 44.3. Formatit i publikimit të kriterëve</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni (Tabela 2) konfirmohet se njësi bazë ka 10 staf ndihmës akademik në mbështetje të procesit mësimor dhe kërkimor. Ai mbështet realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës</p>

<p>mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>specifike të programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion është vendosur kontakt edhe me personelin ndihmës akademik në laboratorët përkatëse.</p> <p><b>Evidenca 56.1. Tabelat përmbledhëse: Tab. 2, tab. 5</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Konfirmohet nga vizita në institucion (Takimi në zyrën e personelit) se UBT mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik apo ndihmës akademik, efektiv apo me kontratë, ka dosjen e tij me dokumentacionin e plotë. Evidenca 44.1 paraqet listën e dokumentacionit që gjendet në dosjen personale të çdo punonjësi në UBT. Të dhënat personale ruhen veçmas sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><b>Evidenca 20.1. CV stafi.</b></p> <p><b>Evidenca 44.1. Formati i dosjes personale</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion është konfirmuar se njësia bazë, përmes marrëveshjeve në nivel institucional, ka marrëdhënie shkëmbimi dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë lokalë dhe rajonalë të cilët ndihmojnë studentët për rekrutimin dhe punësimin. Një sërë aktivitete mundësojnë lidhjen mes universitetit dhe këtyre aktorëve.</p> <p><b>Evidenca 34.1. Marrëveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit</b></p> <p><b>Evidenca 34.2 Lista e sipërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve marrëveshje me UBT</b></p> <p><b>Evidenca 35.2: UBT_Marrëdhënie inst.Publike 2021-2022</b></p>






të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik dhe kordinatorin e programit) konfirmohet se studentët mbikëqyren nga një personel akademik gjatë praktikave jashtë UBT. Lista e personelit akademik propozohet nga kordinatori i programit të studimit.</p> <p>Në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara midis Institucioneve, studentëve u krijohen kushtet për kryerjen e praktikës në terren. Konfirmohet se personi përgjegjës i cili mbikëqyr praktikën mban komunikim me përfaqësuesit e institucionit duke krijuar e realizuar lehtësim në krijimin e kushteve të kryerjes së praktikës. Gjatë vizitës në institucion janë referuar monitorimi i studentëve gjatë praktikës mësimore. Në përfundim të praktikës studentët paraqesin dokumentacionin dhe mbrojnë një temë të përgatitur nga puna në këto institucione.</p> <p><b>Evidenca 35.2: UBT_Marrdhënie Inst.Publike 2021-2022</b></p> <p><b>Evidenca 53.1. Praktikrat profesionale.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni përmbush kriteret për staf të kualifikuar dhe mbështetës për programin. Ai ka bërë përpjekje të lavdërueshme për të rritur bashkëpunimin ndër-institucional.</i></p> <p><i>GVJ vëren se duhet të përmbushet kriteri për titullarët e kategorisë Profesor dhe numrin e lëndëve që mbulojnë si titullar.</i></p> <p><i>GVJ vëren se ngarkesa e stafit të përfshirë duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin 29, i ndryshuar, si për numrin e lëndëve që mbulon çdo PAE në semestër dhe numrin e orëve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Evidenca 42 me të gjitha anekset nën këtë evidencë, mbi infrastrukturën dhe mjediset e FBM ku zhvillohet ky program studimi referon se mjediset e DMBN në FBM janë në godinën qendrore. Studentët zhvillojnë mësim (leksione, seminare, laboratore) në mjedise të mjaftueshme. Përmbushen kërkesat për hapësirë për një student (4.44m<sup>2</sup> hapësirë të disponueshme) dhe 40.8 m<sup>2</sup> për cdo punonjës.</p> <p>Vizita në institucion konfirmon se godina është e pajisur edhe me mjete për ndriçim alternativ, ujë, internet, vende çlodhje e qëndrimi, projektorë, system mbrojtjeje nga zjari, shkallët e emergjencës, shërbim ndihme të shpejtë etj. FBM dhe DMBN mirëmbahet dhe plotëson standardet për infrastrukturën.</p> <p>GVJ konfirmon se FBM ka mjedise mësimore të nevojshme për auditore leksionesh, salla seminaresh, laboratore, zyra etj. Për realizimin e programit të studimit Bch MBN. Evidenca 42 dhe vizita në institucion konfirmojnë se Laboratori LAME, përmbush të gjitha kriteret për të realizuar kërkimin shkencor nga ana e personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca 42.1 Raporti i ekspertit për infrastrukturën</b></p> <p><b>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën e UBT dhe laboratorët</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konfirmon prej vizitës në mjediset e FBM se janë mjediset mësimore të nevojshme për salla leksionesh, seminaresh, laboratore, zyra etj të pajisura me mjetet logjistike për të përdorur teknologjinë e informacionit si kompjutera, video-projektorë, lidhje interneti.</p> <p>Takimi me studentët dhe stafin akademik e kanë konfirmuar cilësinë e mjediseve dhe kushteve për zhvillimin e mësimit dhe praktikave në laborator.</p> <p><b>Evidenca 42.1 Raporti i ekspertit për infrastrukturën</b></p> <p><b>Evidenca 42. Të dhëna për infrastrukturën e UBT dhe laboratorët</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas</p>	<p>Konfirmohet nga vizita në mjediset e institucionit se DMBN disponon 8 salla mësimore, Laboratori i analizave fiziko kimike. GVJ vlerëson së sipërfaqet janë të mjaftueshme për</p>

<p>natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>grupet laboratorike dhe studentë që mund të punojnë në mënyrë të pavarur. Departamenti shfrytëzon edhe kapacitetet e tjera të UBT si struktura laboratorike dhe ferma eksperimentale.</p> <p>GVJ vëren se janë të pajisur dhe me kushte të përshtatshme për realizimin e programit mësimor.</p> <p><b>Evidenca 22.2. Listë e pajisjeve</b></p> <p><b>Evidenca 22.5. Foto laborator</b></p> <p><b>Evidenca 42.1. Raport i ekspertit për infrastrukturën</b></p> <p><b>Evidenca 42.3. Planvendosje e laboratorit shkencor.</b></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ ka vizituar edhe një laborator shkencor të akredituar “Lab shkencor i mjedisit”. Ai është janë të pajisur me linjë interneti për zhvillimin e mësimin online apo kërkim literature dhe shërbime të tjera IT.</p> <p>Nga takimi me sftin akademik konfirmohet se personeli akademik në zyrat e tij është i pajisur me kompjutera personalë, internet e paisjet e nevojshme për punë e pregtitjen mësimore.</p> <p><b>Evidenca 22.2. Listë e pajisjeve</b></p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se kushtet e IAL janë të favorshme për realizimin e një procesi mësimor cilësor dhe praktike mësimore dhe/ose shkencore për të thelluar njohuritë e marra në auditor. IAL ka infrastrukturën e nevojshme për mësimin digjital dhe përdorimin e internetit në mësim dhënie dhe kërkim shkencor.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="544 1332 745 1435"></th> <th data-bbox="745 1332 936 1435">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="936 1332 1134 1435">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1134 1332 1359 1435">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="544 1435 745 1494"></td> <td data-bbox="745 1435 936 1494"></td> <td data-bbox="936 1435 1134 1494"></td> <td data-bbox="1134 1435 1359 1494">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve</p>	<p>Bazuar në sillabuset e lëndëve në Bch Menaxhim i Burimeve Natyrore, GVJ vëren se sillabuset përmbajnë literaturë bazë</p>

<p>në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>dhe të rekomanduar. Sugjerime specifike për këtë pikë janë dhënë edhe në <b>Standardin II.4, Kriteri 5.</b></p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik është referuar se UBT ka vënë në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse, e cila ofrohet në formë fizike dhe digjitale gjë e cila garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit Bch.</p> <p>Studentët kanë mundësi të gjejnë literaturë në fondin e dedikuar të librave në bibliotekën e universitetit “Mentor Përmeti” dhe të përdorin librarinë elektronike me anë të portalit të bibliotekës online ku mund të konsultohen me materiale të literaturës ndërkombëtare me deri në 10,000 tituj në vit.</p> <p>Në faqen e web të UBT, nën seksion Biblioteka (<a href="https://www.ubt.edu.al/sq/biblioteka-e-universitetit">https://www.ubt.edu.al/sq/biblioteka-e-universitetit</a>), renditen edhe burimet online të shfrytëzimit të literaturës së kësaj biblioteke apo edhe burime të tjera. Nuk ka informacion rreth shkallës së shfrytëzimit të këtyre burimeve.</p> <p><b>Evidenca 42.2. Planimetria e bibliotekës Mentor Përmeti.</b></p> <p><b>Evidenca 45.1 Plani strategjik i bibliotekës shkencore</b></p> <p><b>Evidenca 45.2-45.4 Informacion mbi fondin dhe akreditimin e bibliotekës Mentor Përmeti.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në vijim të vlerësimit të GVJ dhënë në Standardin II.4 për literaturën e listuar në sillabuset e lëndëve, takimi me stafin akademik konfirmon se pedagogu i lëndës informon studentët mbi literaturën e nevojshme. Ai referon në Departament nevojat për literaturë më të fundit. Vizita në bibliotekën e UBT konfirmon përditësimet në fondin e kësaj biblioteke (Evidencë 45.4: Hyrjet e reja nëntor-dhjetor 2022).</p> <p>GVJ e kishte të vështirë të vlerësonte shpenzimet buxhetore për literaturë për këtë program.</p> <p><b>Evidenca 45.4. Hyrjet e reja nëntor-dhjetor 2022.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion është verifikuar prania e burimeve të literaturës në institucion në mjediset e bibliotekës. GVJ konfirmon se UBT ka vënë në dispozicion përdorimin e sallave të studimit, librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me literaturën ndërkombëtare. Studentët mund të përdorin sallat e studimit në bibliotekën shkencore Mentor Përmeti, ashtu edhe bibliotekën online (e aksesueshme në çdo</p>



<p>studentët e programit të studimit.</p>	<p>kohë) në faqen <a href="https://www.ubt.edu.al/sq/biblioteka-e-universitetit">https://www.ubt.edu.al/sq/biblioteka-e-universitetit</a>.</p> <p>Frekuentimi i bibliotekës prej studentëve gjatë vizitës në mjediset e saj ishte minimal. Takimi me stafin akademik konfirmon se personeli akademik është i gatshëm të vendosë në dispozicion të studentëve çdo material të nevojshëm të parashikuar në programet lëndore përkatëse.</p> <p><b>Evidenca 45.2-45.4 Informacion mbi fondin dhe akreditimin e bibliotekës Mentor Përmeti.</b></p> <p><b>Evidenca 47.1. Struktura e website të UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 47.5. Linqe informuese</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e bibliotekës e Mentor Përmeti në UBT, ku u njoh se ajo është e pajisur me fond librash e tekstesh. Fondi i teksteve të lidhura me programin është deri në 10000 tituj (Evidenca 45).</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale të literaturës ndërkombëtare. Fondi online duhet parë me përparësi për shkak të kostove më të ulta dhe mundësisë së aksesimit më të lehtë prej studentëve. Referohet se biblioteka në FEA mund të krijojë mundësi aksesimi në rreth 200 revista shkencore ndërkombëtare.</p> <p><i>Lidhja e fondit me literaturën e sugjeruar në sylabuse duhet të jetë e përditësuar me botimet më të fundit.</i></p> <p><b>Evidenca 45.2-45.4 Informacion mbi fondin dhe akreditimin e bibliotekës Mentor Përmeti.</b></p> <p><b>Evidenca 47.1. Struktura e website të UBT.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon nga takimet me studentët se UBT / FBM ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për të gjithë studentët e programit të studimit Bch MBN në bibliotekat online që mund të aksesohen edhe përmes faqet së internetit të UBT. Në takimin me përfaqësuesit e studentëve u referua përdorimin e burimeve online kur kërkohen nga pedagogët.</p> <p><b>Evidenca 47.1. Struktura e website të UBT.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike</p>	<p>GVJ ka vërejtur gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës shkencore Mentor Përmeti në UBT është e pajisur me kompjutera dhe pajisje teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa</p>

<p>dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>kufizim për të gjithë studentët. Biblioteka ne FEA ka rreth 12 kompjutera që mund të përdoren nga studentët për të aksesuar mbi 200 revista shkencore on line si dhe fondin online TEEAL.</p> <p><b>Evidenca 45.2-45.4 Informacion mbi fondin dhe akreditimin e bibliotekës Mentor Përmeti.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Vizita në mjediset e bibliotekës dhe biseda me studentët konfirmon se biblioteka, është e hapur në çdo ditë të javës përfshirë edhe të shtunën me orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre në oraret, përkatësisht nga e hëna në të premte në orarin 8.00-16.00.</p> <p><b>Evidencë: Vizita në institucion.</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga Evidenca 45.3 dhe vizita në mjediset e bibliotekës konfirmoi se kryhet raportim mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit). Përditësimi është vjetor bazuar në informacionin nga stafi akademik.</p> <p>Punonjësit e bibliotekës konfirmojnë se pedagogët paraqesin kërkesat e tyre për fondin e librave me të cilat pasurohet në vijim.</p> <p><b>Evidenca 45.1 Plani strategjik i bibliotekës shkencore</b></p> <p><b>Evidenca 45.2-45.4 Informacion mbi fondin dhe akreditimin e bibliotekës Mentor Përmeti.</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se mjediset dhe shërbimet e ofruara për studentët lidhur me burimet e informacionit dhe bibliotekën janë të disponueshme dhe bëhet përpjekje për përditësimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme.</i></p>

	<p><i>Fondi i teksteve të lidhura me programin është i mjaftueshëm dhe reflekton tërësisht listën e literaturës së detyrueshme për studim në sillabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se duhet specifikuar qartë literatura e detyruar lidhur me emërtimin e ciklit të leksioneve, autorin dhe vitin përkatës për disa nga sillabuset e programit. Për literaturën e rekomanduar të referohen edhe faqet e internetit ku mund të aksesohet ose biblioteka e UBT.</i></p> <p><i>Sugjerohet që literatura e rekomanduar për disa lëndë, ku lista është mjaft e gjerë, të jetë më e përmbledhur në literaturën e viteve të fundit apo e specifikuar me temat ku ajo ndihmon në zgjerimin e dijeve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
		X		

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në evidencën 46.1 dhe takimet në institucion (Takim me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore) GVJ konfirmon se UBT disponon sistem të menaxhimit Pitagora nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky është sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve, ku administrohet i gjithë informacioni lidhur nga fillimi i studimeve dhe deri në përfundim të tyre.</p> <p>Vizita në mjediset e sekretarisë mësimore konfirmon se ajo menaxhon dhe administrojnë të gjithë informacionin e studentëve i cili gjendet në bazën e të dhënave dhe në regjistrin themeltar të notave. Studentët mund të aksesojnë në këtë system informacion të përgjithshëm si orari, pagesat dhe listën e notave të marra gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve universitare në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b></p> <p><b>Evidenca 46.1 Manual përdorimi për sistemin Pitagora.</b></p>


<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion (Takimi në DBNj) GVJ konfirmon se ka sistem të brendshëm që administron të dhënat, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ, i cili është i aksesueshëm në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave. Gjithashtu, të dhënat për studentët janë të aksesueshme në platformën online Pitagora duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>UBT ka të botuara një sërë manualesh për mënyrën se si të regjistrohen online dhe hapin faqe në web. Studentët komunikojnë dhe informohen për vlerësimet përmes sistemit elektronik dhe emailit zyrtar të pedagogëve dhe studentëve.</p> <p><b>Evidenca 5.1. Rregullore e studimeve universitare në UBT.</b></p> <p><b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b></p> <p><b>Evidenca 13.1: Rregullore e DVBSK 2022</b></p> <p><b>Evidenca 46.1 Manual përdorimi për sistemin Pitagora</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon nga takimet me stafin akademik dhe studentët se sistemi i menaxhimit Pitagora ka integruar platforma që mundësojnë regjistrimin e lëndëve të studentit, si dhe të dhëna mbi orarin mësimor, vlerësimet, tarifën e studimit etj. Personeli akademik referon se ka komunikim të vazhduar me studentët me anë të adresave elektronike institucionale.</p> <p>GVJ konfirmon prej informacionit të mbledhur nga studentët se platforma Microsoft Teams është përdorur për të dhënë leksionet, video dhe literatura të tjera përkatëse në funksion të zhvillimit të procesit mësimor, sidomos gjatë periudhës së pandemisë. Studentët mund të marrin informacion në çdo kohë pranë SSMSHs.</p> <p><b>Evidenca 43.1. Analiza e punës mësimore kërkimore të DMBN për vitet 2019-2022</b></p> <p><b>Evidenca 46.1 Manual përdorimi për sistemin Pitagora.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet</p>	<p>Evidenca 46.1 referon se sistemi i menaxhimit Pitagora ka të integruar disa platforma të informacionit të përgjithshëm dhe specifik sic janë orari dhe programi mësimor, tarifën dhe pagesat dhe listat e notave për çdo student individualisht. Gjatë vizitës në institucion studentët referojnë se e përdorin këtë system dhe marrin informacion prej tij, paralelisht edhe me përdorimin e shërbimeve pranë zyrës së SSMSHs.</p>



personelit akademik dhe studentëve.	<b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b> <b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b> <b>Evidenca 46.1 Manual përdorimi për sistemin Pitagora.</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Evidenca 46.1 referon se sistemi i menaxhimit Pitagora garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit mësimor si dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna për organet dhe autoritetet drejtuese. GVJ e ka të pamundur të vlerësojë efikasitetin e punës së këtij sistemi për të parë në kohë reale ecurinë e proceseve. Për sistemin e vlerësimit ky akses është i mundur për studentët dhe pedagogët.  <b>Evidenca 6.1. Rregullore e FBM.</b> <b>Evidenca 7.1 Rregullore e Bch MBN</b> <b>Evidenca 46.1 Manual përdorimi për sistemin Pitagora</b>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konfirmon se UBT publikon në faqen zyrtare informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme të cilat përditësohen vazhdimisht dhe janë të shkruajtura në gjuhën shqipe dhe në Anglisht. GVJ ka verifikuar dhe konfirmon se informacioni gjendet në <a href="https://www.ubt.edu.al/sq">https://www.ubt.edu.al/sq</a>  <b>Evidenca 47.1. Struktura e website të UBT.</b> <b>Evidenca 47.5. Linqe informuese</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka ndërtuar sistemin mbështetës për menaxhimin dhe komunikimin digjital të stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentët, përmes së cilit shpërndahen informacione të ndryshme lidhur me procesin mësimor dhe vlerësimin</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 50.1 GVJ ka shqyrtuar të dhënat financiare për FBM. GVJ është njohur në takimin me koordinatorin e programit dhe drejtuesit e FBM lidhur me procesin e buxhetimit në nivel institucioni dhe njësisë bazë. Bazuar në Evidencën 50.1 institucioni harton një raport financiar të kostove në nivel fakulteti. Kostot janë të detajuara sipas zërave të buxhetit dhe me analizë të plotë të të ardhurave të gjeneruara dhe shpenzimeve sipas zërave.</p> <p><i>GVJ e ka të vështirë të vlerësojë buxhetimin në nivel programi për shkak të mënyrës së organizimit të buxhetit në nivel institucioni dhe njësisë bazë dhe jo të programeve të studimit.</i></p> <p><b>Evidenca 50.1. Të dhëna të financimit të programit 2021-2022</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 50.1, GVJ vëren se shpenzimet që mbulohen i takojnë pagave për burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për laboratorët.</p> <p>GVJ vëren se të ardhurat kryesore janë nga buxheti i shtetit dhe ato të vetë institucionit (fq 14 -15). Të ardhurat realizohen kryesisht nga tarifa e shkollimit dhe nga disa shërbime për të tretët, dhe shërbimet për studentët.</p> <p>Konfirmohet se deri me tani ky mbulim ka qenë i plotë nga të ardhurat e gjeneruara, me peshën më të madhë në pagat e personelit akademik dhe mbështetës.</p> <p><b>Evidenca 50.1. Të dhëna të financimit të programit 2021-2022</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UBT kryen Auditimin e Brendshëm në periudha vjetore, ku përfshihen të gjitha njësitë bazë. Evidenca 49.1 paraqet Planin Strategjik të Degës së Auditimit të Brendshëm që mbulon periudhën 2019-2021</p> <p><b>Evidenca 49.1. Dega e Auditimit të Brendshëm dhe Planit Strategjik 2019-2021</b></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, është diskutuar mbi procesin e buxhetimit në nivel fakulteti, e cila kryhet çdo vit. Mbi bazën e ndarjes së të ardhurave, fakulteti vlerëson nevojat të cilat përcillen më tej në nivel universiteti.</p> <p><b>Evidenca 50.1. Të dhëna të financimit të programit 2021-2022</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar procesit të buxhetimit, (informacion prej takimit me koordinatorin e programit) deri më tani institucioni ka mundur të garantojë mbulimin financiar të nevojave edhe për këtë program studimi.</p> <p>Kryerja e shërbimeve për të tretët në laboratorin shkencor të akredituar është një mundësi e mirë për të rritur qëndrueshmërinë financiare të institucionit.</p> <p><b>Evidenca 50.1. Të dhëna të financimit të programit 2021-2022</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se kryhet një analizë financiare e thelluar dhe e plotë në institucionin. Nevojat financiare në nivelin e programit mund të specifikohen për të përcaktuar edhe mundësitë e zhvillimit të tij në të ardhmen, në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve. Vlerësohet ofrimi i shërbimeve për të tretët që garanton një qëndrueshmëri financiare më afatgjatë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	
-----------------------------------------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------	--


## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga kqyrja e materialeve që gjenden në Dosjen e Vetvlerësimit të Programit të Studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore, GVJ konstaton se janë paraqitur një sërë aktesh rregullative për ndjekjen e studimeve universitare për të gjithë të interesuarit në këtë program studimi.</p> <p>Sipas Evidencës 5.1 Rregullore e Studimeve Universitare, objekti i kësaj rregulloreje është krijimi i një kuadri koherent dhe operacional mbi studimet universitare në UBT; përcaktimi i rregullave standard të përgatitjes, organizimit dhe administrimit të studimeve universitare; krijimi i hapësirave të nevojshme për një menaxhim fleksibël në nivel të njësive kryesore dhe njësive bazë; rregulloret e programeve të studimit të jenë në përputhje me këtë rregullore e cila është hartuar në përputhje me planet mësimore të programeve të studimit duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi</p> <p>GVJ konstaton gjithashtu se Statuti, Rregullorja e studimeve Universitare, Rregullorja e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, Rregullorja e programit të studimit objekt vlerësimi, janë në përputhje me legjislacionin në fuqi duke përcaktuar dhe specifikuar politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit.</p> <p><b>Evidencë 5.1 Rregullore e Studimeve Universitare</b></p> <p><b>Evidencë 6.1 Rregullore e FBM_2022</b></p> <p><b>Evidencë 7.1 Rregullore e Programit të studimit Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e kandidatëve për studentë deri në përfundimin e statusit të tyre si “studentë” në programin e studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore, garantojnë kushte të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët në:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pranimin e studentëve në programin e studimit;</li><li>• Kushtet e kalimit në vitin pasardhës;</li><li>• Organizimin e praktikave profesionale;</li></ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimin në provime;</li> </ul> <p>Kriteret, procedurat, aktet rregullative janë lehtësisht të aksesueshme në web – in e UBT dhe janë një pasqyrë e qartë për çdo të interesuar për të ndjekur një program studimi në UBT.</p> <p><b>Evidencë 5.1 Rregullore e Studimeve Universitare</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në Rregulloren e programit të studimit, neni 8, konstaton se për tu pranuar në programin e studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore, program i ofruar pranë Departamentit të Mjedisit dhe Burimeve, UBT ju ka dhënë mundësinë për të ndjekur këtë program studimi shtetasve shqiptarë në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MAS. Pranimi i kandidatëve sipas Rregullores, bëhet në bazë të kuotave të paracaktuara nga institucioni dhe të miratuara nga MAS. Në këtë program mund të pranohen vetëm ata persona që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional me jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare. Po sipas këtij neni, në këtë program mund të pranohen edhe persona që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. Për këtë kategori kërkohet që të bëhet ekuivalentimi i diplomës së fituar nga Institucionet arsimore përkatëse sipas akteve nënligjore në fuqi. Kushti i vetëm për të gjithë të interesuarit për të ndjekur këtë program studimi është plotësimi i kriterit të notës mesatare të përcaktuar çdo vit akademik me Vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p><b>Evidencë 7.1 Rregullore e Programit të studimit Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore, neni 8</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimin dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, e cila siç kemi thënë edhe më lart është mbështetur në Rregulloren e studimeve Universitare të UBT, është përcaktuar qartë kriteri për pranimin e studentëve në këtë program studimi, procedura e pranimin dhe e përzgjedhjes e cila është Nota mesatare e vendosur për çdo vit akademik sipas VKM përkatëse, përparimi gjatë ndjekjes së studimeve, kushtet e kalimit në vitin pasardhës, etj.</p> <p>Kohëzgjatja e studimeve në programin Bsc në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi. Në këtë kohëzgjatje nuk merret në</p>

	<p>konsideratë periudha e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. (neni 9 i Rregullores së PS)</p> <p>Kushtet e kalimit të studentit nga njëri vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në nenin 10 të Rregullores së PS. Sipas këtij neni, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë të studimeve nëse ai ka përfituar jo më pak se 30 kredite të vitit të parë. Studenti i vitit të dytë, kalon në vitin e tretë nëse ai ka marrë jo më pak se 80 kredite. GVJ shprehet se Rregullorja e programit është e aksesueshme lehtësisht nga çdo i interesuar si në faqen web të UBT ashtu edhe pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit</p> <p><b>Evidencë 7.1 Rregullore e Programit të studimit Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore, neni 10</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në Sekretarinë mësimore të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit por edhe gjatë takimeve që pati si me Dekanin e këtij Fakulteti ashtu edhe me Përgjegjësën e Departamentit të Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore, GVJ u informua se Institucioni është krejt i hapur për të informuar çdo prind apo edhe çdo person që shfaq interes për të ndjekur një program studimi që ofrohet në këtë Fakultet. Njësoj është përkushtimi i administratës së Institucionit për çdo të interesuar edhe për programet e tjera që ofrohen në UBT.</p> <p><b>Evidencë: Takimet e GVJ në Institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.</p>	<p>Sipas RVB, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm është shprehur se UBT, dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit ndjek politika mbështetëse për kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjilizuara. GVJ, gjatë kqyrjes së materialeve të paraqitura në DVV, nuk konstatoi ndonjë informacion specifik për kriteret e vendosura për personat me aftësi të veçanta.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ mbështetur në Rregulloren e programit të studimit, neni 8 shprehet se Institucioni pranon kandidatë nga shtete të tjera dhe planifikon edhe kuota për ndjekjen e këtij programi nga shtetasit e huaj, shqiptarët e trojeve, gjithmonë duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara nga MAS.</p> <p><b>Evidencë 7.1 Rregullore e Programit të studimit Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore, neni 8</b></p>






<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Për studentët të cilët nuk kanë mundësi të ndjekin studimet duke mos përballuar tarifat e studimit, sipas nenit 31 të Statutit të UBT, institucioni përjashton nga tarifa e studimit të gjithë ato studentë që ndjekin një program studimi të ciklit të parë si dhe një program të integruar të studimeve.</p> <p>Ndërsa për studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve dhe që nuk kanë mundësi financiare për të përballuar koston e studimeve, përjashtimi ose reduktimi nga tarifa vjetore e shkollimit bëhet me Vendim të Bordit të Administrimit pasi është marrë vendimi paraprak nga Senati akademik.</p> <p><b>Evidencë 2.1 Statuti I UBT, neni 31, Tarifa e studimit</b></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit si Njësia kryesore dhe Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve natyrore si njësia bazë për ofrimin e programit të studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore, kanë hartuar politika dhe procedura për pranimin, dhe njohjen e krediteve, duke i respektuar ato.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi V.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ konstaton se studenti merr informacionin e duhur për programin e studimit dhe njëkohësisht edhe për kalimin nga një vit akademik në tjetrin gjatë kohës që do të studiojë në programin e studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore. Këtë informacion e merr nëpërmjet Sekretarisë mësiore, por edhe nëpërmjet faqes web të UBT. Në rregulloren e programit, në nenin 10 të saj, kushtet e kalimit të studentit nga njëri vit në tjetrin janë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme. Konkretisht në këtë nen citohet: “Viti akademik mbyllet në përfundim të sezonit të vjeshtës”.</p> <p>Për programin e studimit të menaxhimit të burimeve natyrore, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse i ka marrë jo</p>



	<p>më pak se 30 kredite të vitit të parë. Ky numër kreditesh mund të ndryshohet me vendim Rrektorati/Senati.</p> <p>Studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ka marrë jo më pak se 80 kredite. Ky numër kreditesh mund të ndryshohet me vendim Rrektorati/Senati</p> <p>Po sipas nenit 10 të Rregullores, Studenti që nuk plotëson kriteret për të kaluar në vitin pasardhës ka këto detyrime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- I njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur porgramet e moduleve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim;</li> <li>- Mund të frekuentojë modulet për të cilat është vlerësuar mbetës dhe është i detyruar të frekuentojë modulet për të cilat ka detyrim frekuentimin;</li> <li>- Duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit e programeve mësimore</li> <li>- Duhet të paguajë tarifën e shkollimit;</li> </ul> <p><b>Evidencë 7.1 Rregullore e Programit të studimit Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore, neni 10</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Duke qënë se programi i studimit është program i ciklit të parë, Bachelor, për tu pranuar në këtë program studimi, sipas nenit 8 të Rregullores së programit të studimit, por edhe rregullores për studimet universitare-UBT_2022, mbi të cilën është mbështetur Rregullorja e programit, studentët të cilë kanë dëshirë të ndjekin programin e studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore, pranohen sipas udhëzimeve dhe kuotave të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MAS për vitin akademik përkatës. Në këtë program mund të pranohen vetëm ata persona që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë përfunduar jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare. Në këtë program mund të pranohen edhe studentë të cilët kanë marrë një diplomë të shkolëls së mesme jashtë vendit. Për këtë kategori kërkohet që të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar prej tyre në vendin e huaj nga komisioni përktës në MAS. Pranimi në këtë program studimi është i mundur për çdo kandidat që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me Vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p><b>Evidencë 7.1 Rregullore e Programit të studimit Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore, neni 8</b></p>



**Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.

GVJ konstaton se për programin e studimit student merr informacion të detajuar në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve, nëpërmjet:

- Udhëzimeve përkatëse nga Sekretaria mësimore;
- Rregullores së studimeve universitare të UBT;
- Rregullores së programit të studimit;
- Syllabuseve të lëndës të cilat e kanë të përcaktuar formen e kontrollit të dijeve;

Forma e kontrollit të dijeve paraqitet në syllabuse në përqindje të ndryshme, në varësi të lëndës;

Psh, në një syllabus (Bazat e prodhimit shtazor);

- Frekuentimi 80 %;

Kontrolli i vazhdueshëm:

- Pjesëmarrja dhe angazhimi në seminare/laboratore 30%;
- Detyra kontrolli (testime ndërmjetëse/detyra kursi 10 %;
- Provim përfundimtar (me shkrim dhe me gojë) 60%;

Në syllabusin e lëndës “Bujqësia dhe Burimet Natyrore” paraqitet si më poshtë:

- Frekuentimi 80%

Kontrolli i vazhdueshëm:

- |                                    |      |
|------------------------------------|------|
| • Praktika                         | 10 % |
| • Detyra kontrolli/test ndërmjetës | 10 % |
| • Projekt kursi                    | 20 % |
| • Provim final                     | 60%  |

Në syllabusin e lëndës “Energjitë alternative” paraqitet si më poshtë:



- Frekuentimi 80%

Kontrolli i vazhdueshëm:

- |                                              |      |
|----------------------------------------------|------|
| • Seminare                                   | 10 % |
| • Detyra kontrolli/test ndërmjetës           | 10 % |
| • Detyrë kursi                               | 20 % |
| • Provimi përfundimtar me shkrim dhe me gojë | 60%  |

**Evidenca 19.2.12 E. Kullaj\_Bujqësia Burimet Natyrore**



	<b>Evidenca 19.2.11 E. Jojic_Energjite alternative</b>			
	<b>Evidenca 19.2.22 L. Papa_Bazat e prodhimit shtazor</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se në Rregulloren e programit të studimit në nenin 13 të saj janë të përcaktuara qartë përgatitja e punimit të diplomës së ciklit të parë. Në këtë nen është shkruar shprehimisht:  <i>Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studneti dhe pedagogu. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.</i>			
	<b>Evidencë 7.1 Rregullore e Programit të studimit Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore, neni 13</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nga shyrtimi i RVB por edhe gjatë takimeve që realizuam në Institucion, GVJ u informua se Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore në fillim të vitit të parë të studimeve, në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera në nivel instiucional, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilës prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion në lidhje me përmbajtjen e programit Bsc në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore, vendndodhja e auditoreve, zyrave dhe sekretarisë mësimore, infrastruktura në funksion të këtij programi, orari i shfrytëzimit të bibliotekës, etj			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ pohon se në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore vihet dhe ka një informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	



**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët e këtij programi informohen në mënyrë të hollësishme për gjithçka që ofrohet në Fakultetin e Bujqsisë dhe Mjedisit dhe më konkretisht në Departamentin e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore në përgjithësi dhe atë në funksion të programit të studimit, objekt vlerësimi, në veçanti. Gjithashtu, siç edhe u informuam gjatë vizitës në Institucion, studenti merr informacion të plotë edhe për organizimin e programit të studimit, kohëzgjatjen e tij, kreditet totale, kreditet me të cilat mund të kalojë nga viti i parë në vitin e dytë dhe kreditet totale me të cilat mund të kalojë nga viti i dytë në vitin e tretë. GVJ u informua se studentët marrin informacion të përafërt edhe për sezonet e provimeve dhe detyrimet e studentit për tu futur në këto provime. Sistemi i menaxhimit të informacionit dhe sekretaria mësimore janë në funksion të të gjithë të interesuarve për këtë program studimi.</p> <p>GVJ konfirmon gjithashtu se Objektivat formuese të lëndëve gjenden edhe në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Me strukturën e programit mësimor, studenti njihet paraprakisht në Rregulloren e programit të studimit. Ndërsa në vijimësi të frekuentimit të programit, njohja bëhet më e ngushtë.</p> <p>Sipas Rregullores së programit, neni 6, miratuar në vitin 2022, struktura e programit paraqitet si më poshtë:</p> <p>Veprimtaria formuese e programit të studimit në drejtimin menaxhim i Burimeve Natyrore, klasifikohet në:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>Module të formimit të përgjithshëm;</li><li>Module të formimit karakterizues të programit;</li><li>Module të formimit të ngjashme ose/dhe integruese me modulet karakterizuese;</li><li>Module formuese të zgjedhura nga studentët nëpërmjet atyre që ofron departamenti/fakulteti;</li><li>Module formuese dhe aktivitete që lidhen me përfitimin e aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikë, praktikë;</li></ol>



	<p>f. Teza e diplomës ose provimi i formimit</p> <p>GVJ konstaton se sipas përmbajtjes së rregullore së programit, veprimtaritë formuese ndahen në kategoritë nga A në F, ndërkohë që nuk janë në koherencë me VKM nr 41/2018 të ndryshuar, në të cilën Veprimtaritë formuese duhet të ndahen nga A në E</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur në DVV, konkretisht Evidenca 14.3_Plani mësimor Bach MBN i ndarë sipas veprimtarisë Formuese (A-E)</p> <p>Në emërtim të kësaj evidence nënvizohet ndarja e veprimtarisë nga A në E, ndërsa në brendësi kjo evidence veprimtaritë i ndan në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I – veprimtari në disiplina të formimit të përgjishëm (bazë) – Simboli A – 11 lëndë të përfshira – 56 kredite (31%)</li> <li>• II – veprimtari në disiplina karakterizuese të programit të studimit – Simboli B – 11 lëndë të përfshira – 66 kredite (37%)</li> <li>• III – veprimtari në disiplina të ngjashme ose/dhe integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese – Simboli C – 6 lëndë të përfshira – 36 kredite (20%)</li> <li>• IV – Disiplina me zgjedhje të studentit – Simboli D – 4 lëndë të përfshira – studenti zgjedh dy prej tyre – 8 kredite (4%)</li> <li>• V– Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhë të huaj, ligjshmëri, prezantuese, stazh apo prakika, etj – Simboli E – Gjuhë e huaj – 4 kredite (2%)</li> <li>• VI– Praktikë profesionale teza (provimi i diplomës) – Simboli F –10 kredite (6%)</li> </ul> <p><i>GVJ rekomandon që Institucioni duhet të marrë masa që të bëjë përshtatjen e ndarjes në planin mësimor të veprimtarive formuese nga A në E sipas akteve ligjore në fuqi.</i></p> <p><b>Evidencë 7.1 Rregullore e Programit të studimit Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore, neni 6</b></p> <p><b>Evidenca 14.3: Plani mësimor Bach MBN i ndarë sipas veprimtarisë Formuese (A-E)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen</p>	<p>Në dosjen e vetvlerësimit është paraqitur dokumentacioni me Evidencë Nr 17.1_ Studimi i tregut të punës Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore_FB_07_10_2022. Objekti i këtij studimi është Vlerësimi i kërkesave të tregut të punës dhe kryesisht të</p>

<p>institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>kompanive private për specilistë të versimit të impakteve mjedisore, formimin profesional të specialistëve të rinj dhe potencialet për punësim në këtë sektor.</p> <p>Vleresimi i hapësirës së punësimit në institucionet lokale dhe publike; përmirësimi në kurikulën e studimeve për programin përmes identifikimit dhe ofrimit përmes saj të më shumë kompetencave profesionale.</p> <p>GVJ konstaton se ky material është goxha i mirëmenduar duke përfshirë në të qasjet kërkimore; Rëndsinë e studimit; situatën makroekonomike; situatën e tregut të punës; punësimin sipas sektorëve ekonomikë; punësimin në sektorin privat në industrinë me ndikim mjedisor; punësimi dhe niveli i pagave; oferta arsimore në fushën e mjedisit; segmentet e tregut të punës që shenjestron programi, etj.</p> <p><b>Evidencë Nr 17.1: Studimi i tregut të punës Bsc Menaxhim i Burimeve Natyrore_FB_07_10_2022.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët e këtij programi informohen në mënyrë të hollësishme për infrastrukturën e institucionit në përgjithësi dhe atë në funksion të programit të studimit, objekt vlerësimi, në veçanti. Gjithashtu, ashtu siç edhe u informuam gjatë vizitës në Institucion, por siç e kemi shprehur edhe më lart, Studenti merr informacion të plotë nga Departamenti, pedagogët e lëndëve dhe sekretaria mësimore për organizimin e procesit mësimor, orët e leksioneve, seminareve, laboratorët, praktikat mësimore, ndarjen e lëndëve sipas moduleve, kreditet përkatëse për secilën prej tyre, orët në auditor dhe jashtë auditorit, etj. Sistemi i menaxhimit të informacionit dhe sekretaria mësimore janë në funksion të të gjithë të interesuarve për këtë program studimi. Informacioni i plotë përcillet nga Sekretaria mësimore edhe nëpërmjet email të studentëve. Sipas Rregullores së Universitetit Bujqësor për studimet Universitare, neni 104, Informimi i studentëve, në UBT është ngritur dhe funksionon një sistem i organizuar informacioni për të transmetuar tek studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me gjithçka që ka të bëjë me programin e studimit. GVJ-së ky fakt ju pohua edhe gjatë vizitës në Insitucion.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacionin e plotë studentit e merr në tre forma:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletë palosjeve, procedurave që gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në format elektronik në website-in e UBT, i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët pjesë e UBT;</li> <li>- Në format letër të shpallura në mjediset e përcaktuara të UBT, si orari mësimor, njoftime të ndryshme, rezultatet e kontrollit, etj;</li> </ul> <p><b>Evidencë 5.1 Rregullore e Universitetit Bujqësor për studimet Universitare, neni 104</b></p>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konfirmon se në dispozicion të studentëve është vënë një informacion i plotë për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Vërehet se ndarja e lëndëve nuk është sipas veprimtarive nga A në E, sipas VKM Nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar Institucioni duhet të marrë masa të bëjë ndryshimet përkatëse për ndarjen e lëndëve sipas akteve nënligjore në fuqi. Është shumë e rëndësishme ky fakt dhe ndërhyrja e Departamentit duhet të jetë e menjëhershme.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të programit, por edhe planit strategjik për zhvillimin e institucionit, GVJ konstaton se UBT në përgjithësi dhe, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore në veçanti, si njësitë përgjegjëse për ofrimin e programit Bsc në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore paraqesin raporte vjetore për veprimtarinë e kryer. Shkëmbimi i informacionit me qëllim mbajtjen e statistikave vjetore të studentëve dhe të diplomuarve, realizohet nga Sekretaria mësimore, e cila është e përcaktuar edhe në bazën Rregullative që shoqeron këtë program studimi.

	<p>Sipas Evidencës që gjendet në DVV, të dhënat për studentët në këtë program studimi, janë si më poshtë:</p> <p>Të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Viti akademik 2019 – 2020                      88 studentë</li> <li>• Viti akademik 2020 – 2021                      54 studentë</li> <li>• Viti akademik 2021 – 2022                      24 studentë</li> <li>• Viti akademik 2022 - 2023                      9 studentë*</li> </ul> <p>Numri i studentëve për vitin aktual akademik, 2022-2023 është marrë në raportin e e analizës së punës mësimore dhe këkimore shkencore për vitin akademik 2021-2022, pika 1.1, Evidencë 38.8</p> <p>Nga vizita në sekretarinë mësimore u morën këto të dhëna për numrin e studentëve në këtë program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Viti akademik 2020 – 2021                      54 studentë, nga të cilët 3 studentë janë çrregjistruar</li> <li>• Viti akademik 2021 – 2022                      24 studentë, nga të cilët 3 studentë janë çrregjistruar</li> <li>• Viti akademik 2022 - 2023                      8 studentë</li> </ul> <p>Studentë të diplomuar në vitin akademik 2020-2021 janë 35 gjithsej, nga të cilët 31 studentë janë femra.</p> <p><b>Aneksi 58: RVB_programi studimit Bsch_MBN</b></p> <p><b>Evidencë 4.1: Plani Strategjik UBT_2016-2025</b></p> <p><b>Evidencë 27.1: ZSS_Evidencë e std. të rregjistruar&amp;diplomuar 2018-2021</b></p> <p><b>Evidencë 27.3: ZSS_Evidencë e std. të çrregjistruar 2018-2021</b></p> <p><b>Evidencë 38.8: DMBN_Analiza e mësim-kerkim-2022</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe i Rregullores së Universitetit Bujqësor të Tiranës për studimet Universitare, por edhe gjatë konfirmimeve dhe takimeve të realizuara nga GVJ në institucion, Sekretaria mësiore dhe e shërbimit për studentët, disponon të dhëna të sakta për studentët e programit të studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore.</p> <p>Referuar nenit 105 të rregullores për studimet universitare të UBT, objekt i veprimtarisë së sekretarisë mësimore dhe shërbimit për studentët është regjistrimi i studentëve dhe mbajtja e bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre; plotësimi dhe dorëzimi i të gjithë dokumentave individuale çertifikues mbi rezultatet e pjeshme ose të plota të studimeve;</p>

mbajtja e dokumentacionit; mbajtja e bazës së të dhënave mbi studentët dhe çertifikimin individual të studimeve të kryera; ofrimi i shërbimeve dhe informimi mbi studimet dhe studentët në nivel Universiteti.

Nga vizita në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoit se Sekretaria mësimore administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të porcesit mësimor në rregjistrin themeltar, në rregjistrin e notave dhe në rregjistrin e diplomimit. Gjithashtu GVJ pa se kjo sekretari disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të rregjistruar, tërheqjet nga programi i studimit, largimet para perfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalje.

Sipas Evidencës Nr 27.3, të dhënat për studentët e çregjistruar janë si më poshtë:

Studentë të çregjistruar në këtë program studimi sipas viteve:

- Viti akademik 2019 – 2020 3 studentë
- Viti akademik 2020 – 2021 9 studentë
- Viti akademik 2021 – 2022 1 student

Nga vizita në sekretarinë mësimore u morën këto të dhëna për numrin e studentëve në këtë program studimi dhe për numrin e studentëve të çregjistruar:

- Viti akademik 2020 – 2021 54 studentë, nga të cilët 3 studentë janë çregjistruar
- Viti akademik 2021 – 2022 24 studentë, nga të cilët 3 studentë janë çregjistruar
- Viti akademik 2022 - 2023 8 studentë

Siç shikohet edhe nga të dhënat e mësipërme, ka një mosrakordim të numrit të studentëve të çregjistruar sipas Evidencës në DVV me të dhënat e marra në Sekretarinë mësimore për vitin 2020-2021 dhe 2021-2022 (minutat e takimit)


Sipas Evidencës nr 27.2, evidencë e notës mesatare ndër vite e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi është si më poshtë:

- Viti akademik 2020 – 2021 nota mesatare 7.10 (më e ulëta 6.50 dhe më e larta 8.24)
- Viti akademik 2021 – 2022 nota mesatare 7.23 (më e ulëta 6.57 dhe më e larta 9.19)

Vërehet se përgjithësisht për dy vitet e referuara është një notë mesatare relativisht e kënaqshme, por duhet më shumë



	<p>punë nga studentët të cilët këkojnë të ndjekin një program të ciklit të dytë.</p> <p><b>Evidencë 5.1 Rregullore për Studimet Universitare-UBT_2021</b></p> <p><b>Evidencë 27.2: ZSS_Evidencë e mesatares te std. 2018-2021</b></p> <p><b>Evidencë 27.3: ZSS_Evidencë e std. të çregjistruar 2018-2021</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se sekretaria mësimore e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu kjo Sekretari ruante të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe çregjistrimet e studentëve, ecurinë akademike të studentit, si dhe të dhënat për studentët që diplomohen.</p> <p>Sekretaria e ruante dokumentacionin fizik por edhe elektronikisht. Gjatë takimit me studentët, GVJ ju tha se nëpërmjet platformës “classroom” marrin informacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm.</p> <p><b>Evidencë: Minutat e takimit dhe vizita fizike në Institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Drejtoria e vlerësimit të brendshëm dhe e sigurimit të cilësisë dhe sektori i sigurimit të cilësisë janë përgjegjëse për kontrollin periodik pranë njësive për menaxhimin e të dhënave, sic është Sekretaria mësimore. Sipas nenit 3 të Rregullores së Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë, kjo Drejtori ndjek problemet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor në UBT, me të gjitha procedurat, aktivitetet dhe dokumentat për vlerësimin e programeve të studimit në nivel institucioni, kontrollin dhe harmonizimin e dokumentave administrative që rregullojnë zhvillimin normal të procesit mësimor në nivel fakulteti me dokumentat e këtij lloji në nivel universiteti.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësues të kësaj Drejtorie, GVJ ju tha se kontrolli ushtrohet në mënyrë periodike dhe deri më tani nuk ka patur asnjë problem me të dhënat që disponon Sekretaria mësimore. UBT është një nga Universitetet që aplikon sistemin Pitagora, sistem i inicuar nga Rrjeti akademik i shqipërisë (RASH). Në dosjen e vevtlerësimit paraqitet edhe manuali i përdorimit të këtij sistemi nga Sekretaria mësimore.</p> <p><b>Evidencë 8.1 Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe sigurimit të cilësisë – UBT_2021</b></p>




	<b>Evidencë 46.1: Manual për studentin në lidhje me sistemin Pitagora</b>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Ashtu siç na u deklarua edhe gjatë vizitës në Institucion, por mbështetur edhe në atë çka është paraqitur edhe në Raportin e Vlerësimit të brendshëm, Departamenti i Mjedisit dhe i Burimeve Natyrore, si njësia bazë në të cilën ofrohet programi i studimit Bsc në ‘Shkenca Mjedisore’, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore ndjek vijueshmërinë e këtij programi me qëllimin për të evidentuar arritjet duke patur si synim shtrirjen e tyre në nivel Fakulteti dhe më tej në nivel Institucional; për të evidentuar problematikën dhe për të gjetur mundësitë për zgjidhje; si dhe për të vendosur objektiva të reja dhe standarde më cilësore të punës mësimore për vitin akademik pasardhës.</p> <p>Gjatë takimit që pati GVJ me stafin akademik, këtij grupi ju tha se mundësitë për punësimin e studentëve që përfundojnë bachelorin janë të pakta. Studentët duhet të mbarojnë ciklin e dytë të studimeve dhe pastaj të punësohen. Ishte fakt që pothuajse 100% e studentëve që frekuentonin këtë program studimi ndiqnin studimet e ciklit të dytë, master dhe akoma nuk kanë përfunduar për të parë dhe analizuar mundësinë e punësimit.</p> <p>Ndërsa studentët e pranishëm në takimin me GVJ ishin të qartë që pas përfundimit të studimeve për këtë program do aplikonin për të marrë licensën si ekspertë mjedisi dhe pastaj të vijonin studimet.</p> <p><b>Evidencë 38.8 DMBN – Analiza e mesim_kerim – 2022</b></p> <p><b>Evidencë: Minutat e takimeve gjate vizitës në UBT</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ shprehet se Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore si njësiti kryesore dhe bazë për ofrimin e programit të studimit ruajnë dhe administrojnë të dhëna në lidhje me studentët që kanë ndjekur në vite këtë program që nga hyrja e tyre dhe deri në diplomim.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës, ka parashikuar dhe ka bërë realitet përfaqësimin e studentëve të tij në organet kolegjinale të institucionit. Mbështetur në Statutin e UBT, në nenin 54 të tij shkruhet se studentët e UBT kanë të drejtë të përfaqësohen në organet kolegjinale të UBT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me Statutin e UBT. Po në statutin e UBT, neni 56 shkruhet se Studentët e UBT gëzojnë të drejtën e organizimeve të tyre, të cilat janë të pavarura dhe nuk zhvillojnë veprimtari politike apo partiake. Këto organizime promovojnë pjesmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese kolegjinale të UBT, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve të tij.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët e UBT janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjinale të Institucionit. Sipas RVB por edhe sipas takimeve në institucion, studentët përfaqësohen në Senatin akademik, në Komisionin e etikës, në komisionin për sigurimin e cilësisë së programit të studimit dhe të kërkimit shkencor</p> <p><b>Evidenca 2.1: Statuti i UBT</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit në Institucion, GVJ ju tha se Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit ka anagazhuar studentë të këtij programi në procesin e akreditimit të programit, duke përcjellë në grupin e vlerësimit të brendshëm zërin potencial të studentëve. Programi është i ri, i hapur para 5 viteve dhe akoma nuk është parë e arsyeshme nga Fakulteti dhe Departamenti të bëhet ndonjë ndërhyrje në të që nga koha e licensimit.</p> <p>Pyetësorët organizohen dhe realizohen nga Drejoria e Sigurimit të Cilësisë. Nga takimi që patëm me përfaqësues të kësaj drejtorie, GVJ ju komunikua se pyetësorët realizohen në fund të çdo semestri. Pjesmarrja e studentëve është deri në masën 30% Rezultatet e pyetësorit përpunohen nga Zyra e Sigurimit të cilësisë, ku me anë të një relacioni njoftohet Zv Rektori dhe Rektori i UBT. Të dhënat e pyetësorit përfshihen edhe në analizën vjetore të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e</p>	

mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjithashtu GVJ ju tha se nuk ka patur probleme madhore të konstatuara në pyetësorët e studentëve.  <b>Evidencë: Minutat e takimeve gjatë vizitës në UBT</b>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se UBT ka të përfshirë në organet kolegjiale të tij studentët si në Senatin akademik (3 studentë), komisionin e etikës (1 Student) dhe në Komisionin e sigurimit të cilësisë (1 student) sipas përcaktimeve në Statutin e UBT por gjithmonë duke u mbështetur në aktet normative të UBT.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>


#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Gjatë takimit në Institucion me Sektorin e Karrirrës dhe Alumni, GVJ ju komunikua se përfaqësues të këtij Sektori bëjnë promovimin e programeve që ofrohen në UBT. Para përfundimit të vitit shkollor, nëpër gjimnazet e vendit bëhen prezantime të programeve të studimit, shpërndahen fletë palosje në të cilat janë të dhënat bazike rreth programit të studimit. Gjithashtu për të interesuarit jepet informacion mbi bursat dhe kategorinë e studentëve që përfitojnë nga këto bursa. I gjithë ky informacion bëhet i mundur nëpër shkollat e mesme të vendit në periudhën Mars – Qershor.  Gjithashtu kjo zyrë angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve Bachelor. Studentëve u jepet informacion i detajuar në lidhje me lëndët/modulet, kreditet përkatëse, orarin e zhvillimit të mësimin, praktikat




	profesionale, pedagogët e lëndës, laboratorët në funksion të programit, etj
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Siç e kemi shprehur edhe më lart, GVJ konstaton se nëpërmjet faqes zyrtare web të UBT por sidomos nëpërmjet Sekretarisë mësimore, studentët kanë mundsi të informohen për mënyrën e rregjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistemin Pitagora, aksesin në sistemin Clasroom, parashikimet për sezonin e provimeve, detyrimet ndaj lëndëve të caktuara, orarin e mësimve dhe laboratorin përkatës për lëndët laboratorike, etj. Informacioni më i plotë dhe më i gjerë është i mundur nëpërmjet sistemit Pitagora. Mjafton që studenti të japë të dhëna të sakta në sekretarinë mësimore (email) dhe nëpërmjet këtij sistemi merret informacioni i nevojshëm dhe i duhur në çdo kohë dhe në çdo ambient.</p> <p><b>Evidencë Nr 47.1: Struktura e faqes zyrtare UBT</b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>GVJ mbështetur në dosjen e vetvlerësimit por kryesisht mbështetur në takimin më përfaqësues së Zyrës së karrierës dhe Alumni në UBT, konstaton se kjo zyrë është në funksion të studentëve apo edhe kandidatëve për student nëpërmjet informacionit që përcjell. Kjo zyrë është në mbështetje të planifikimit të karrierës së studentëve nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, aktiviteteve të ndryshme që zhvillon UBT në kuadër të bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, etj. GVJ gjatë takimit ju tha se herë pas herë kjo Zyrë trajnon studentët për formulimin e një CV sipas formateve ndërkombëtare.</p> <p>Mbështetur në Statutin e UBT, Zyra e Karrierës dhe Alumni së bashku me Drejtorinë e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga UBT.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e	<p>GVJ pa me kujdes edhe dokumentin e paraqitur në DVV të Qendrës së Karrierës dhe Alumni, raport i përgatitur nga Koordinator i kësaj qendre në vitin 2020, me të dhënat e bazuara përgjatë vitit akademik 2019-2022</p> <p>Në fakt pas këtij viti nuk ka ndonjë të dhënë tjetër se si është vepruar në vitet në vazhdim.</p> <p>Sipas këtij Raporti, një nga funksionet e QKA është edhe të gjurmojë ecurinë e studentëve të UBT në tregun e punës, mbasi ato përfundojnë studimet dhe diplomohen. Procesi i studimit primar ka patur përpilimin e pyetësorëve i përbërë nga tre</p>




<p>autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>seksione: profili i studentit; vlefshëmria e diplomës së UBT për tregun e punës; punësimi i tyre. Targeti i studimit kanë qenë studentët të cilët, të paktën kanë qënë të diplomuar që prej një viti nga koha e studimit. Sipas studimit, më shumë kanë qënë studentët e Fakultetit të Ekonomisë dhe agrobiznesit që i janë përgjigjur pyetësorit.</p> <p>Për sa më sipër, GVJ e vlerëson punë e kësaj Qendre, por të dhënat në DVV duhet të jepeshin për fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, pjesë e të cilës është edhe programi i studimit Bsc në shkencë Mjedisore, profili menaxhim i Burimeve Natyrore. Gjithashtu kjo qëndër duhet të nxjerrë të dhëna për çdo vit akademik për punësimin e studentëve që mbarojnë studimet në UBT.</p> <p><b>Evidencë: Minutat e takimeve gjatë vizitës në UBT</b></p> <p><b>Evidencë 2.1 Statuti i UBT, neni 84</b></p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ shprehet se UBT ka marrë masa dhe ka struktura që merren me informimin e studentëve, këshillimin e tyre përgjatë viteve që janë pjesë e këtij Institucioni. <u>Duhet të punohet më shumë për gjurmimin e studentëve pas përfundimit të studimeve nga zyrat dhe sektorët përkatës.</u></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës, në shërbim të cilësisë së mësimdhënies dhe në funksion të studentëve që ndjekin programet e ofruara në këtë Universitet, ka një bazë</p>

<p>zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>rregullative të mirëformuar e cila është paraqitur nga Grupi i Vlerësuesve të Brendshëm të programit të studimit Bsc në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore, në Dosjen e Vetvlerësimit. Në këto rregullore jepen direktiva të qarta për zhvillimin e kurikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore në procesin mësimor. Kjo bazë orienton punën që duhet bërë në lidhje me strukturën e programeve mësimore, pranimin e studentëve, regjistrimin e tyre, kushte e kalimit në vitin pasardhës, organizimin e praktikave profesionale, organizimin e provimeve, përgatitjen e diplomës, etj.</p> <p>GVJ duke kqyrur syllabuset e lëndëve, në disa prej tyre pa që pedagogu i lëndës shprehet edhe për metodat inovative të mësimdhënies/praktikës. Psh:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në syllabusin e lëndës “Atmosfera dhe kontrolli i cilësisë së ajrit”, në fund të tij është shruajtur shprehimisht: <i>studentët në prktikat laboratorike do të punojnë në grupe dhe në seminare do të aplikohet metoda interactive si dhe të kryhen testet e ndërmjetme</i></li> <li>- Në syllabusin e lëndës “Bazat e shkencës së Tokës”, në fund të tij është shruajtur shprehimisht: <i>Temat e lëndës janë të shoqëruara me mësim praktikë si punë laboratorike që ndihmojnë studentët të njohin dhe të përvetësojnë teknikat lbortorike t vlerësimit të treguesve tokësorë si dhe të përvetësojnë më mirë njohuritë e dhëna në mësimet teorike. Studentët do të punojnë një project kurs ku sintetizohen njohuritë teorike dhe praktikë</i></li> <li>- Në syllabusin e lëndës “Gjeoshkenca Mjedisore”, në pëmbledhjen dhe në rezultatet e të nxëniet, është shruajtur shprehimisht: <i>kursi realizohet nëëprmet observimeve, anlizave dhe moduleve që tashmë janë pjesë e metodologjisë së studimi të rruzullit të tokës dhe hapësirës.</i></li> </ul> <p><b>Evidencë 5.1: Rregullore për studimet universitare_UBT_2021</b></p> <p><b>Evidencë 7.1: Rregullore e programit të studimit Bach Menaxhim i Burimeve Natyrore</b></p> <p><b>Evidencë: Syllabuset e tre lëndëve: “Atmosfera dhe kontrolli i cilësisë së ajrit”; “Bazat e shkencës së Tokës”; “Gjeoshkenca Mjedisore”</b></p>
<p><b>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit</b></p>	<p>Nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë, monitoron dhe vlerëson aftësitë e mësimdhënies së</p>



<p>dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>personelit akademik. Nga takimi që patëm me përfaqësues të kësaj Drejtorie, GVJ mësoi se në përbërje të saj janë Sektori i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Programeve dhe Kurikulave. GVJ ju tha se cilësia në UBT garantohej në: ecuria e procesit mësimor që në fillimin e një cikli studimi; strukturën mësimore, duke monitoruar ngarkesën mësimore të pedagogëve; shikohet ana teknike e perputhshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo Drejtori funksionon në bazë të Rregullores së saj të miratuar me vendim senati.</p> <p><b>Evidencë 9.1: Rregullore DVBC_2021</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Drejtorja e Vlerësimit të brendshëm dhe e sigurimit të cilësisë organizon në mënyrë periodike pyetësorët për studentët dhe i bën të ditur nëpërmjet një relacioni Zv Rektorit dhe më tej përcillen edhe tek Rektori i UBT. Rezultatet apo problematikat që dalin nga pyetësorët përfshihen edhe në analizën vjetore të Fakultetit. GVJ ju komunikua se nuk ka patur problematika madhore të dala nga këta pyetësorë. Studentët përgjithësisht janë indiferentë dhe marrja pjesë e tyre në plotësimin e pyetësorëve është në masën 30% (në pyetësorin e shpërndarë së fundmi tek studentët)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua gjithashtu se përfshirja e rezultateve të pyetësorëve tek analiza e punës e fakultetit dhe më tej përfshirja e analizës së fakultetit në Raportet e përvitshme vjetore, janë një mënyrë e bërjes publike të rezultateve të vlerësimit. Raportet e përvitshme vjetore publikohen në faqen eeb të UBT, me qëllimin që të mund të vijnë në ndihmë çdo të interesuari në lidhje me strukturën dhe funksionimin e Institucionit.</p> <p><b>Evidencë: Minutat gjatë vizitës në UBT</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sipas Rregullores së DVBC, kjo drejtori ndjek me përgjegjësi ndër të tjera edhe problemet që lidhen me përgatitjen e standardeve për hartimin e dokumentacionit që rregullon realizimin e procesit mësimor; ecurinë e zbatimit të kurikulave gjatë vitit akademik; kontrollon mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të provimeve gjatë vitit akademik, etj. Përgjithësisht, ashtu siç edhe ju tha edhe GVJ gjatë vizitës, në këtë program studimi nuk ka patur problematika. Rezultatet e vlerësimit të kësaj drejtorie nuk kanë shërbyer për të penalizuar, por për të përmirësuar dhe nxitur në mënyrë</p>



	konstruktive aty ku është parë e arsyeshme që të mund të ndodhë.			
	<b>Evidencë 9.1: Rregullore DVBC_2021</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shpreht se Institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Vlerësimit të brendshëm dhe të sigurimit të cilësisë, ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në Ligjin e arsimit të lartë Nr 80/2015 dhe në Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë. Kjo Drejtori është pjesë e strukturës organizative të UBT dhe funksionon si njësi ndihmëse e Rektoratit. Kjo Drejtori ndjek problemet që lidhen me procesin mësimor në UBT, me aktivitetet dhe dokumentat për vlerësimin e programeve të studimit në nivel institucioni, kontrollin dhe harmonizimin e dokumentave administrative, etj.</p> <p>Rregullorja e DVBC është mbështetur dhe funksionon në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’ si dhe në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Statutin e UBT</li> <li>- Kodin e punës</li> <li>- Kodin e procedurave Administrative</li> <li>- Rregulloren e studimeve të UBT-së</li> </ul>
	<b>Evidencë 9.1: Rregullore DVBC_2021</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në	Siç e kemi shprehur edhe më lart, në UBT funksionon Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe e Sigurimit të Cilësisë. Kjo

<p>funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Drejtori funksionon në bazë të rregullores së saj, ku janë të përcaktuara qartë funksionet dhe përgjegjësitë, detyrat dhe kompetencat. Pjesë e kësaj drejtorie janë Sektori i Programeve dhe i Kurikulave (SPK) dhe Sektori i Sigurimit të Cilësisë (SSC)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVI mbështetur në këtë Rregullore, në përgjigje të pëloësimit të kriterëve përkatësë, shprehet sa më poshtë:</p> <p>Sektori i Programeve dhe i Kurikulave (SPK) ndjek problematikat që kanë lidhje me mësimin dhe merret me përgatitjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet e studimit. Konkretisht, ky Sektor ndjek: mbarëvajtjen e procesit mësimor; dokumentacionin që ka lidhje me programet mësimore; siguron përputhshmërinë e kurikulave me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; kontrollon ecurinë e zbatimit të kurikulës përgjatë vitit akademik, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Ky sektor mbështet edhe Sektorin e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional në rastet e përgatitjes së raporteve për vlerësimin e programeve të studimit në proces të akreditimit dhe të riakreditimit të tyre, gjithmonë duke mbështetur çështjet e kurikulës dhe të mësimin. Në raste kur shikohet e arsyeshme, ky sektor kërkon edhe mendimin e ekspertëve të jashtëm, në përgatitjen e materialeve të kërkuara, ose të raporteve të vlerësimit. Gjithashtu ky sektor propozon zgjidhje konkrete në lidhje me ankesat apo kërkesat e ndryshme të paraqitura nga individë, grupe studentësh apo edhe pedagogësh në lidhje me probleme të veçanta në mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Sektori i sigurimit të cilësisë (SSC) merret me përgatitjen e standardeve për hartimin e dokumentacionit që rregullon realizimin e procesit mësimor në nivel Universiteti. Gjithashtu SSC programon kalendarin e procesit të vetvlerësimit në nivel universiteti dhe ndjek realizimin e tij; koordinon procesin e akreditimit të programeve të studimit për të gjitha ciklet e studimit dhe departamentet pranë UBT; koordinon dhe bashkëvepron me Fakultetet dhe departamentet për vlerësimin, riorganizimin, apo aplikimin e programeve të reja të studimit. Ky sektor në bashkëpunim me Zv Rektorin për anën mësimore ka kompetencë të përgatisë udhëzime në mbështetje të procesit të vlerësimit të brendshëm programor apo institucional; të përgatisë formatet standarde për pyetësorët e studentëve dhe të stafit akademik; si dhe të përgatisë manualin për sigurimin e cilësisë në UBT dhe ta formalizojë atë pas miratimit në strukturat vendimmarrëse.</p>


	<b>Evidencë 9.1: Rregullore DVBSK_2021</b>			
	<b>Evidencë 37.1: Manuali i Cilësisë_2018</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ, përsa më lart, shprehet se institucioni ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

### Standardi VI.3


**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në UBT ju komunikua nga disa burime ngritja dhe funksionimi i strukturave të sigurimit të cilësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë, e cila funksionon sipas Rregullores së saj.</p> <p>Sipas kësaj Rregulloreje, Sektori i Sigurimit të Cilësisë, pjesë e kësaj Drejtorie, merret me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programimin e kalendarit të vetëvlerësimit dhe ndjek realizimin e tij;</li> <li>- Koordinimin e procesin të akreditimit të programeve të studimit për të gjitha ciklet e studimit dhe departamentet pranë UBT;</li> <li>- Në bashkërendim dhe nën drejtimin e ZV Rekorit për anën mësimore ka kompetencë të përgatisë udhëzime në mbështetje të procesit të vlerësimit të brendshëm programor;</li> <li>- Përgatitjen e formateve standard për sondazhet studentore dhe të stafit;</li> <li>- Inspektimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm të përgatitura nga njësitë dhe kur gjen mosrespektim të standardeve të përshkruara në manualin e sigurimit të cilësisë, ka të drejtë ti kërkojë njësive rregullimin e tyre;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e</p>	<p>Po sipas Rregullores, në lidhje me mbarëvajtjen e procesit të akreditimit të programit, ky Sektor, nëpërmjet Drejtorisë informon me shkrim Drejtorin e saj dhe Zv Rektorin për anën</p>

<p>vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>mësimore për çështje të veçanta që dalin gjatë ndjekjes së procesit të akreditimit.</p> <p>Në funksionet dhe përgjegjësitë e DVSBSC është edhe hartimi i raporteve për bashkëveprimin e strukturave në kuadër të vetvlerësimit; mbarëvajtjes së veprimtarisë mësimore; zbatimin e kurikulave gjatë vitit akademik, etj. Gjithashtu kjo Drejtori i paraqet raporte Rektoratit në lidhje me punën e bërë dhe njëkohësisht i paraqet edhe sugjerime për një përmirësim të mëtejshëm të cilësisë. Kjo Drejtori përditëson edhe informacionin në faqen web të ASCAL në lidhje me të dhënat që këkon ky institucion për përbërjen e departamenteve dhe Fakulteteve të UBT.</p> <p>GVJ pati rastin që të takonte përfaqësues të kësaj Drejtorit gjatë vizitës në institucion dhe, gjithçka që është e shkruajtur në Rregullore, Ju pohua ekspertëve të jashtëm edhe gjatë takimit me ta. Kryesorja që na u theksua për sigurimin e cilësisë për këtë program studimi, të gjithë si staf akademik por edhe administrative janë shumë bashkëpunues duke dashur që ky program të jetë sa më cilësor.</p> <p><b>Evidencë 9.1: Rregullore DVBSBSC_2021</b></p> <p><b>Evidencë 37.1: Manuali i Cilësisë_2018</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor një sërë të dhënash për vlerësimin e programit të studimit dhe stafit akademik, sikundër janë: monitorimi i procesit të mësimdhënies; vlerësimin nga studentët për çdo lëndë; rezultatet e studentëve në provime; rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit; rezultatet e punimit dhe mbrojtjes së diplomës etj. Sipas Rregullores së Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, pranë këtij Fakulteti funksionojnë si organe kolegjiale, edhe Komisionet e përhershme që lidhen me kërkimin shkencor dhe garantimin e standardeve të cilësisë të programeve të studimit si: Komisioni për sigurimin e cilësisë së programit të studimit dhe të kërkimit shkencor dhe Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.</p> <p>Përgjegjësia kryesore e Komisionit të sigurimit të brendshëm të cilësisë lidhet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrjen pjesë në hartimin e raportit vjetor të vetvlerësimit (institucional dhe programor)</li> </ul>



<p>shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Promovimin dhe nxitjen e vetëdijes së brendshme për të gjitha njësitë për çështjet e cilësisë</li> <li>- Krijimi e besueshmërisë për vlerësimin e jashtëm për të gjithë aktorët</li> <li>- Ofrimin e asistencës dhe informacionin e azhurnuar mbi çështjet e sigurimit të cilësisë që i përmbahen kërkesave të reja ligjore</li> </ul> <p><b>Evidencë 9.1: Rregullore DVBSK_2021</b></p> <p><b>Evidencë 6.1: Rregullore e FBM_2022</b></p> <p><b>Evidencë 37.1: Manuali i Cilësisë_2018</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumenta të tërthorta vlerësimi, si: pyetësor për vlerësimin e stafit akademik nga studentët; pyetësor për stafin akademik; analiza vjetore e fakultetit në të cilën pasyrohen të gjitha gjetjet /mendimet apo sugjerimet e vërejtura në plotësimin e këtyre pyetësorëve; analiza e tregut të punës për programin e studimit. Ashtu siç jemi shprehur edhe më lart, akoma nuk ka një analizë të mirëfilltë për këtë program studimi, pasi studentët që kanë mbaruar këtë program janë në ndjekje të ciklit të dytë të studimeve. Pavarësisht kësaj, analiza e tregut të punës, është një proces që realizohet në nivel institucional nga Qendra e Karrierës dhe Alumni.</p> <p><b>Evidencë 29.2: Raport performance e QKA_2019-2022</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se UBT nëpërmjet Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe dy Sektorëve të saj, kryesisht Sektorit të Sigurimit të Cilësisë, monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit Bachelor në Shkenca Mjedisore, profili Menaxhim i Burimeve Natyrore, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përgjigje të këtij kriteri, GVJ u mbështet në manualin e cilësisë, i cili gjendet në Dosjen e Vetvlerësimit. Sipas këtij manuali: <i>UBT si institucion është i ndergjegjshëm se cilësia dhe pëmirësimet e vazhdueshme të cilësisë janë parakusht për zhvillimet afatgjata të këtij institucioni, duke plotësuar edhe pritshmëritë e aktorëve jashtë Universitetit. Për të arritur sigurimin e cilësisë, UBT ka zhvilluar një politikë të sigurimit të cilësisë dhe ka ngritur një sistemim të menaxhimit të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UBT, është konceptuar si</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>përgjegjësi e menaxhimit-angazhimi i strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë;</i></li> <li>- <i>Sigurimi i burimeve për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë;</i></li> <li>- <i>Mësimdhënia, mësimi, hulumtimi dhe shërbimet – përmes zhvillimit dhe shpërndarjes së programeve cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë;</i></li> <li>- <i>Analiza dhe përmirësimi – përmes përcaktimit të parimeve, standardeve, procedurave dhe metodave për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë;</i></li> </ul> <p><b>Evidencë 37.1: Manuali i Cilësisë_2018</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nga kqyrja paraprake e raportit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit Bachelor në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore, por edhe mbështetur nga takimet e shumta që u realizuan gjatë vizitës në Institucion, në hartimin e këtij raporti janë përfshirë stafi akademik, stafi ndihmës akademik dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, duke sjellë problematikat sipas kategorive dhe duke bërë maksimumin për një pasqyrim sa më real të programit të studimit që nga koha e licensimit të tij dhe deri në këtë fazë, fazën e akreditimit për herë të parë.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, na u komunikua se ky Grup vjen nga një eksperiencë e mëparshme e vlerësimit në kuadër të akreditimit të një programi tjetër të ofruar nga FBM. Programi në fjalë është një nga programet e rëndësishme të Departamentit dhe në përbërje të tij janë staf me eksperiencë dhe personel administrativ po me eksperiencë dhe prej vitesh në UBT.</p> <p><b>Evidencë Aneksi 58-RVB_programi I studimit BsSch_MBN</b></p> <p><b>Evidencë Minutat gjatë takimit në UBT</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e studimeve universitare, në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, në Rregulloren e DVSBSC, si dhe në Manualin e Cilësisë së UBT, rezulton se Institucioni, UBT, rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve, pjesë përbërëse të UBT.</p> <p><b>Evidencë 5.1: Rregullore për studimet universitare_UBT_2021</b></p> <p><b>Evidencë 6.1: Rregullore e FBM_2022</b></p> <p><b>Evidencë 9.1: Rregullore DVSBSC_2021</b></p> <p><b>Evidencë 37.1: Manuali i Cilësisë_2018</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Referuar RVB, vetë Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shprehet për këtë kriter se në sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përfshirë ekspertë të jashtëm për laboratorin shkencor, i cili është pjesë përbërëse e infrastrukturës së programit të studimit. Përveç këtij fakti, GVJ në materialet e sjella në DVV nuk gjeti ndonjë dokument ku të flitej për përfshirjen e ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me cilësinë e programit të studimit.</p> <p><b>Evidencë Aneksi 58-RVB_programi i studimit BsSch_MBN</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se Institucioni në proceset e SBC-së të programit të studimit ka përfshirë stafin akademik dhe stafin administrativ me përvojë dhe me eksperiencë në drejtim të</i></p>




	<i>procesit të vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu ka të përfshirë edhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre në vetvlerësimin e programit. GVB informon hierarkinë e institucionit për masat dhe problematikat e ndryshme gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit të brendshëm. <u>GVJ sugjeron</u> që Institucioni duhet të marrë masa për përfshirjen e ekspertëve të jashtëm duke marrë prej tyre mendime në lidhje me cilësinë e programit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				X


### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarisë në kuadër të sigurimit të cilësisë. Çdo veprimtari e inicuar nga Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë është publike për studentët dhe të interesuarit. Veprimtaritë në funksion të garantimit të cilësisë mbështeten nga Statuti i UBT dhe nga baza rregullative e këtij institucioni.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton se me përfundimin e procesit të akreditimit, UBT ka të shpallur në faqen e tij zyrtare vlerësimin përfundimtar të akreditimit të programeve të studimit që ofrohen në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, konform legjislacionit duke respektuar lirinë, etikën akademike si dhe të dhënat personale.  Sipas evidencës Struktura e faqes zyrtare të UBT, institucioni ndjek disa Politika të publikimit të Informacionit në web, ku materialet para se të publikohen në faqen e Universitetit Bujqësor të Tiranës dëgohen nga ZV Dekanët për Doktoraturat dhe menaxhimin e Karrierrës me e-mail, Përgjegjëses së Zyrës së Mësimit&Kurikulave dhe Sektorit të IT-së.  Mbas verifikimit dhe sigurimit të cilësisë së të dhënave, përgjegjësja e Zyrës së Mësimit dhe Kurikulave i jep të drejtë



	<p>Sektorit të IT-së për të publikuar, përditësuar të dhënat dhe informacionet në faqen zyrtare të UBT-së</p> <p><b>Evidencë 47.1: Struktura e faqes zyrtare UBT</b></p> <p><a href="https://www.ubt.edu.al/akreditim-fbm">https://www.ubt.edu.al/akreditim-fbm</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Referuar dokumentave të paraqitura në Dosjen e vetvlerësimit të programit Bsc në Shkenca Mjedisore, profil Menaxhim i Burimeve Natyrore, GVJ konstaton se Institucioni pas analizave si për procesin mësimor, ashtu edhe për funksionimin në tërësi të programeve të studimeve që ofrohen në Departamentin e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore, del me rekomandime konkrete, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rekomandimet lidhen me programet e studimit; me procesin mësimor; me stafin akademik; me studentët; me organizimin dhe menaxhimin e brendshëm; me kërkimin shkencor;</p> <p>Në fund të analizës mësimore kërkimore, Departamenti del me përfundime të cilat i adreson në autoritetet e UBT. Konkretisht, referuar analizës mësimore kërkimore të Departamentit të Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore, për vitin 2022 janë cituar këto përfundime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfundimi dhe mobilimi i godinës së re;</li> <li>- Promovimi i programeve të studimit të nivelit bachelor;</li> <li>- Mbështetje financiare për kërkimin dhe publikimet;</li> </ul> <p><b>Evidencë 43.1.1 DMBN _ analiza e mësim kërkim – 2019-2020</b></p> <p><b>Evidencë 43.1.2 DMBN _ analiza e mësim kërkim - 2021</b></p> <p><b>Evidencë 43.1.3 DMBN _ analiza e mësim kërkim - 2022</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në plotësim të këtij kriteri GVJ shprehet se nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi me përfaqësues të DVBSK, rezulton se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, stafin ndihmës akademik dhe me studentët për ti informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe të programeve të studimit në veçanti.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se Drejtoria e vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë ndjek politika dhe procese për sigurimin</i></p>



	<i>e cilësisë dhe sigurisht i bën publike ato duke patur në vëmendje dhe respektuar lirinë, etikën akademike si dhe të dhënat personale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhimi i Burimeve Natyrore”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Universiteti Bujqësor i Tiranës është një institucion i arsimit të lartë me traditë institucionale shumëvjeçare, që krijon një bazë të fortë dhe të qëndrueshme edhe për këtë program studimi të ciklit të parë Bachelor;
2. Bazuar në nevojat e vendit, programi i studimit ka krijuar fizionominë e tij përmes kontributit të stafit akademik dhe atij ndihmës për hartimin e programit dhe të kurrikulës lëndore, bazuar në përvojën e gjatë dhe kualifikimin e plotë me ekspertizë në këtë fushë studimi sin ë mësim dhënie ashtu edhe në kërkimin shkencor;
3. Institucioni ka infrastrukturë të plotë dhe të pajisur mirë për të mbështetur procesin mësimor dhe kërkimor shkencor në këtë program studimi, përfshirë salla leksionesh, seminaresh, laboratore, bibliotekën dhe mjedise të tjera të përbashkëta;
4. Programi i studimit mundëson formimin e specialistëve të rinj në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore dhe mjedisit dhe krijon lidhjen me tregun e punës, kryesisht duke adresuar nevojat e tij në institucione dhe agjenci të ndryshme;
5. Institucioni dhe njësia bazë kanë hartuar të gjithë dokumentacionin rregullator dhe mbështetës për funksionimin e programit;

**b. Pika të dobëta:**

1. Institucioni duhet të tregohet më i kujdesshëm në përcaktimin e saktë të emërimit të programit ashtu siç është emërtimi në dokumentin e hapjes/licensimit të tij nga Ministria përkatëse; **(Standardi I.1, konkluzione)**

2. Shpërndarja e lëndëve dhe orëve (krediteve) sipas tipologjisë, nuk paraqitet në përpjestimin e duhur për ti dhënë një peshën e duhur lëndëve që i takojnë formimit bazë dhe atij karakterizues kundrejt lëndëve të tjera ndërdisiplinore apo plotësuese; **(Standardi II.1, kriteri 3)**
3. Literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse të jetë e përditësuar për të gjitha lëndët e programit; **(Standardi II.4, kriteri 5)**



#### **Rekomandime:**

1. Institucioni duhet të rishikojë shpërndarjen e lëndëve në këtë program studimi për të përmbushur kërkesat/rekomandimet e VKM-së;
2. Institucioni duhet të rishikojë ngarkesën mësimore për PAE dhe shpërndarjen e orëve/lëndëve përgjatë semestrave për të gjithë stafin akademik, bazuar në specifikimet ligjore në fuqi;
3. Institucioni duhet të përfshijë edhe ekspertë të jashtëm në vlerësimin e cilësisë, krahas mekanizmave dhe përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve;
4. Në sillabuset e çdo lënde, literatura e detyruar duhet specifikuar qartë dhe referuar botimeve të viteve të fundit, ndërsa literatura e rekomanduar të jetë më e përmbledhur në literaturën e viteve të fundit apo e specifikuar me temat ku ajo ndihmon në zgjerimin e dijeve, si dhe rekomandohet një përdorim më i gjerë prej studentëve i literaturës në sistemin digjital, për marrjen e literaturës më të fundit në kohë të shpejtë dhe me kosto të arsyeshme;
5. Institucioni duhet të ketë një mekanizëm kontrolli lidhur me plagjaturën në punimet e studentëve;
6. Institucioni duhet të përmirësojë mënyrën e planifikimit dhe analizimit të buxhetit për të lejuar identifikimin dhe vlerësimin e qartë të pjesës së buxhetit që shkon për çdo program studimi, përfshirë edhe fondet lidhur me kërkimin shkencor ose bibliotekën;

#### **Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Management of Natural Resources"**

##### **a. Strengths and affirmations:**

1. The Agricultural University of Tirana is a higher education institution with a long-standing institutional tradition, which creates a strong and stable basis for this First Cycle Bachelor's Study Program;
2. Based on the needs of the country, the study program has created its physiognomy through the contribution of the academic and assistant staff for the design of the program and the curriculum, based on long experience and qualifications with expertise in this field of study, teaching as well as in scientific research;



3. The institution has well-equipped infrastructure to support the teaching and scientific research work in this study program, including lecture halls, seminars, laboratories, library and other common facilities;
4. The study program enables the formation of new specialists in the field of natural resources and environmental management. It is linked to the labor market, mainly by addressing its needs of various institutions and agencies;
5. The institution and the responsible unit have developed and approved all the regulatory and supporting documentation for the running of the program;

**b. Weaknesses:**

1. The institution should be pay attention in determining the precise name of the study program as it is stated in the document of its opening/licensing by the relevant Ministry. *(Standard I.1)*
2. The subjects and hours (credits) according to typology, is not presented in the right proportion as stated by the DCM, respecting the share of the subjects that belong to the fundamental and characteristic subjects, compared to other interdisciplinary or complementary subjects; *(Standard II.1, criterion 3)*
3. Mandatory and support literature should be updated with the recent year titles for all subjects of the program; *(Standard II.4, criterion 5)*

**Recommendations**

1. The institution should review the distribution of subjects in this study program to meet the requirements/recommendations of the DCM;
2. The institution must review the teaching workload for full staff personnel (PAE) and the distribution of hours/subjects throughout the semesters for the whole academic personnel, based on the legal specifications;
3. The institution should also include external experts in quality assessment, in addition to the mechanisms and involvement of academic staff and students;
4. In the syllabus of each subject, the obligatory literature must be clearly specified and referred to the publications of recent years, while the recommended literature should be more summarized in the literature of recent years or specified with the topics where it helps to expand knowledge, as well as recommending a wider use by students of literature in the digital system, for obtaining the latest literature in a quick time and at a reasonable cost;
5. The institution must have a control mechanism regarding plagiarism in student works;
6. The institution should improve the budgeting process to allow the the budget share that goes to each study program, including funds related to scientific research or the library;



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>